



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2025 – Numri: 130

Tiranë – E martë, 22 korrik 2025

PËRMBAJTJA

	Faqe
Udhëzim i ministrit të Financave nr. 21, datë 14.7.2025	Për kontrollin e brendshëm dhe verifikimin e masave për zbatimin e instrumentit të facilitetit për reforma dhe rritje..... 19143
Udhëzim i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 22, datë 14.7.2025	Për disa ndryshime në udhëzimin nr. 16, datë 19.10.2022, “Për rregullat për masat e veçanta të kontrollit për të parandaluar hyrjen dhe përhapjen brenda vendit të <i>Xylella fastidiosa</i> (Wells et al)”, të ndryshuar.. 19146
Udhëzim i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 23, datë 15.7.2025	Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr. 18, datë 9.11.2022, “Për aditivët ushqimorë të lejuar”, i ndryshuar..... 19156
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 683, datë 15.7.2025	Për delegim të përkohshëm kompetencash..... 19177
Vendim i Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut datë 12.6.2025	Artan Broci kundër Shqipërisë (<i>kërkesa nr. 57935/18</i>)..... 19177
Vendim i Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 409, datë 16.7.2025	Për miratimin e rregullores “Mbi zhvillimin e procedurave për rivlerësimin e subjekteve nga Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë”..... 19181
Vendim i Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 410, datë 16.7.2025	Për miratimin e rregullores “Për mbledhjet e përbashkëta dhe bashkëpunimin ndërinstitucional ndërmjet Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë”..... 19189
Udhëzim i Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale nr. 5, datë 16.7.2025	Për përpunimin e të dhënave personale nga autoritetet kompetente.. 19193

Urdhër i kryetarit të Autoritetit për
Informimin e Dokumenteve të ish-
Sigurimit të Shtetit nr. 172,
datë 16.7.2025

Për delegim kompetencash nga kryetari i Autoritetit për Informimin
mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit tek Sekretari i
Përgjithshëm.....

19197

**UDHËZIM****Nr. 21, datë 14.7.2025****PËR KONTROLLIN E BRENDSHËM
DHE VERIFIKIMIN E MASAVE PËR
ZBATIMIN E INSTRUMENTIT TË
FACILITETIT PËR REFORMA
DHE RRIJTJE**

Në zbatim të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 9 të ligjit nr. 19/2025, “Për ratifikimin e marrëveshjes së facilitetit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian”, dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 252, datë 2.5.2025, “Për përcaktimin e funksioneve, të përgjegjësiave e të marrëdhënieve midis autoriteteve dhe strukturave përgjegjëse për koordinimin dhe raportimin, sipas parashikimeve të marrëveshjes së facilitetit, ratifikuar me ligjin nr. 19/2025”, ministri i Financave

UDHËZON:**I. QËLLIMI DHE OBJEKTIVAT**

1. Qëllimi i këtij udhëzimi është të përcaktojë procedurat, funksionet dhe rolet për të gjitha institucionet e përfshira në zbatimin dhe monitorimin e Instrumentit të Facilitetit për Reforma dhe Rritje (Instrumenti RGF), në përputhje me Agjendën Kombëtare të Reformave 2024–2027 të miratuar me vendimin nr. 621, datë 10.10.2024, të Këshillit të Ministrave, si dhe me ligjin nr. 19/2025, “Për ratifikimin e marrëveshjes së facilitetit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian”.

2. Udhëzimi përcakton kornizën për zbatimin e mekanizmave të kontrollit të brendshëm dhe auditimit të brendshëm për të garantuar integritetin, transparencën dhe efektivitetin e përdorimit të fondeve në kuadër të këtij Instrumenti. Ai mbështet përgatitjen e Deklaratës së Sigurisë, pjesë e kërkesës për pagesë, sipas kushteve të marrëveshjes së facilitetit dhe siguron zbatimin në praktikë të parimeve të menaxhimit të mirë financiar, në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi për menaxhimin financiar dhe kontrollin dhe auditimin e brendshëm në sektorin publik.

3. Objektivat specifikë të këtij udhëzimi janë:

a) Të përshkruajë proceset dhe hapat për zbatimin e kontrollit të brendshëm dhe auditimit,

duke përfshirë verifikimin e përmbushjes së objektivave dhe treguesve sasiorë e cilësorë, si dhe të përputhshmërisë me parimet horizontale të menaxhimit financiar publik;

b) Të përcaktojë rolet dhe përgjegjësitë e Koordinatorit Kombëtar, ministrisë përgjegjëse për Financat dhe institucioneve të tjera zbatuese, në zbatim të Instrumentit dhe raportimin e tij sipas standardeve të përcaktuara nga BE dhe ligji shqiptar.

II. PARIME DHE KUADRI LIGJOR

1. Zbatimi i këtij udhëzimi bazohet në parimet e kontrollit të brendshëm dhe të auditimit të brendshëm në sektorin publik që përfshijnë:

a) Menaxhim i mirë financiar, efikasitet dhe efektivitet në përdorimin e fondeve publike;

b) Transparencë dhe llogaridhënie institucionale përmes strukturave të raportimit dhe auditimeve të rregullta;

c) Parandalim dhe zbulim i mashtrimit, korrupsionit, konfliktit të interesit dhe shkeljeve të tjera;

d) Sigurimi i pakthyeshmërisë së reformave dhe shmangia e financimit të dyfishtë;

e) Pajtueshmëri me Standardet Ndërkombëtare të Kontrollit të Brendshëm dhe Auditimit, në përputhje me Kornizën e Kontrollit të Brendshëm të Komitetit COSO dhe Standardet Globale të Auditimit të Brendshëm.

2. Zbatimi i kontrollit të brendshëm dhe auditimit, në kuadër të këtij Instrumenti mbështetet në aktet ligjore dhe rregullatore të mëposhtme:

a) Rregullore (BE) 2024/1449 e Bashkimit Evropian, që përcakton kornizën e përgjithshme për zbatimin e facilitetit për reforma dhe rritje;

b) Ligji nr. 18/2025, “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe BE-së për mbështetje buxhetore”;

c) Ligji nr. 19/2025, “Për ratifikimin e marrëveshjes së facilitetit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian”;

d) Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 252, datë 2.5.2025, “Për strukturën dhe mekanizmat institucionalë për zbatimin e marrëveshjes së facilitetit për reforma dhe rritje”;

e) Ligji nr. 114/2015, “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, që rregullon organizimin dhe funksionimin e auditimit të brendshëm në institucionet shtetërore;

f) Ligji nr. 10 296/2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar.



III. STRUKTURAT PËRGJEGJËSE DHE ROLET E TYRE

1. Koordinatori Kombëtar (KK)

1.1. Koordinatori Kombëtar ka për detyrë koordinimin e përgjithshëm të Instrumentit të RGF-së me Komisionin Evropian përfshirë procesin e zbatimit të reformave dhe investimeve në kuadër të Instrumentit të RGF-së. Përgatit së bashku me ministrinë përgjegjëse për financat dhe nënshkruan deklaratën e sigurisë.

2. Zyra Mbështetëse e Koordinatorit Kombëtar (ZMKK)

2.1 ZMKK-ja mbështet Koordinatorin Kombëtar në koordinim dhe monitorim të Instrumentit RGF. Përgatit raportet gjashtëmujore dhe vjetore, formulon kërkesat për pagesa dhe ofron këshillim teknik për ministritë e linjës, duke konsoliduar raportet përfundimtare.

3. Ministria përgjegjëse për financat

3.1 Ministria përgjegjëse për financat, nëpërmjet strukturës përgjegjëse për kontrollin e brendshëm financiar publik dhe raportimin financiar, ushtron rolin e saj si autoritet koordinues për harmonizimin dhe mbikëqyrjen e sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit (MFK), si dhe të funksionit të auditimit të brendshëm në institucionet e sektorit publik, në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 10 296/2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, dhe ligjit nr. 114/2015, “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, si dhe me nenin 9 të marrëveshjes së facilitetit.

3.2. Në këtë funksion, ministria përgjegjëse për financat:

a) Koordinon dhe monitoron funksionimin e Sistemit të Menaxhimit të Parregullsive, si dhe zbatimin e masave parandaluese dhe korrigjuese ndaj mashtrimit dhe parregullsive;

b) Forcon dhe ndjek nga afër procedurat e kontrollit të brendshëm dhe mekanizmat e raportimit, në lidhje me zbatimin e Instrumentit për reforma dhe rritje;

c) Harton dhe shpërndan udhëzime standarde (p.sh., lista kontrolli) për verifikimin dhe dokumentimin e hapave të reformave nga institucionet zbatuese;

d) Koordinon funksionin e auditimit të brendshëm në institucionet përfutuese dhe përgatit përmbledhjen e konsoliduar të auditimeve të kryera në kuadër të përgatitjes së deklaratës së sigurisë;

e) Përgatit dhe zbaton protokolle bashkëpunimi me institucionet e BE-së, përfshirë Komisionin Evropian, OLAF-in dhe EPPO-në, për çështje që lidhen me mbrojtjen e interesave financiarë të BE-së;

f) Mbledh dhe vlerëson provat verifikuese dhe dokumentacionin mbështetës nga institucionet zbatuese, dhe dorëzon dy herë në vit raportin përgatitor për deklaratën e sigurisë, që i bashkëlidhet kërkesës për disbursimin e fondeve.

4. Ministritë e linjës dhe institucionet zbatues/beneficiare

4.1. Ministritë e linjës dhe institucionet zbatuese janë përgjegjëse për planifikimin, zbatimin, monitorimin dhe raportimin e reformave dhe investimeve të mbështetura nga Instrumenti RGF.

4.2. Detyrimet e ministrive dhe të institucioneve zbatuese përfshijnë:

a) Zbatimin e udhëzimeve të ministrisë përgjegjëse për financat, në lidhje me proceset në kuadër të nënshkrimit të deklaratës së sigurisë;

b) Hartimin e planeve tremujore të zbatimit, të përditësuara në mënyrë të vazhdueshme, në përputhje me objektivat dhe treguesit e Marrëveshjes së Facilitetit;

c) Sigurimin dhe ruajtjen e evidencave dhe provave të verifikueshme, që dokumentojnë zbatimin real të hapave të reformave;

d) Funksionimin efektiv të auditimit të brendshëm, duke kryer auditime të rregullta mbi sistemet e kontrollit të brendshëm në zbatim të Standardeve Globale të Auditimit të Brendshëm dhe kuadrit ligjor kombëtar; si dhe raportimin përkatës pranë strukturës përgjegjëse për harmonizimin e auditimit të brendshëm;

e) Përgatitjen e raporteve periodike gjashtëmujore dhe vjetore, si dhe çdo raport tjetër të kërkuar në kuadër të monitorimit të Instrumentit.

IV. PROCESI I KONTROLLIT TË BRENDSHËM

1. Kontrolli i brendshëm në kuadër të zbatimit të Instrumentit për Reforma dhe Rritje (RGF) është një proces i vazhdueshëm dhe sistematik, që synon të sigurojë përdorimin e ligjshëm, të rregullt, ekonomik, efikas dhe efektiv të fondeve të Bashkimit Evropian, si dhe arritjen e objektivave të reformës të përcaktuara në Agjendën Kombëtare të Reformave 2024–2027.

2. Vendosja dhe funksionimi i sistemit të kontrollit të brendshëm bazohet në **sistemin e**



menaxhimit financiar dhe kontrollit, në përputhje me kuadrin ligjor dhe nënligjor për menaxhimin financiar dhe kontrollin si dhe me **nenin 9 të Marrëveshjes së Facilitetit**, i cili kërkon që autoritetet kombëtare të garantojnë vendosjen e sistemeve të përshtatshme të kontrollit të brendshëm dhe auditimit.

3. Çdo institucion përfitues duhet të sigurojë:

a) Sisteme efektive kontrolli për parandalimin, zbulimin dhe adresimin e financimit të dyfishtë (parimet e kontrollit të brendshëm të njohura ndërkombëtarisht);

b) Sistem transparence për të dokumentuar burimet e financimit për çdo hap/aktivitet;

c) Deklaratë sigurie që vërteton se kontrollet janë zbatuar dhe gjithë burimet janë raportuar;

d) Vetëdeklarimi mbi përmbushjen e detyrimeve të kontrollit dhe auditimit të brendshëm kryhet nga Sekretari i Përgjithshëm në rastet e ministrive dhe nga titullari i institucionit në rastet e ministrave të shtetit, agjencive të varësisë dhe institucioneve të pavarura dhe i dërgohet ministrisë përgjegjëse për financat.

4. Institucionet zbatuese kanë detyrimin të identifikojnë riskun për çdo hap reforme apo investimi që zbatojnë. Ato duhet të hartojnë plane të kontrollit të brendshëm ku përshkruhen qartë aktivitetet e kontrollit, përgjegjësitë, afatet dhe metodat e monitorimit, të cilat duhet të përmbajnë:

a) Zonat me risk të lartë për mospërputhje apo parregullsi;

b) Masat parandaluese dhe korrigjuese për secilin risk të identifikuar;

c) Përgjegjësitë për zbatimin e kontrolleve dhe afatet përkatëse;

d) Metodologjitë e monitorimit dhe vlerësimit të masave.

5. Qasja e bazuar në risk ndihmon në përqendrimin e burimeve në fushat më kritike dhe siguron një nivel të arsyeshëm sigurie për zbatimin korrekt të Instrumentit.

6. Zbatimi i kontrolleve të brendshme përfshin verifikime administrative dhe financiare, të cilat mund të jenë analiza të dokumenteve ose kontrolle në terren. Këto veprime bëhen për të vërtetuar se masat janë zbatuar siç janë planifikuar dhe se fondet janë përdorur në mënyrë të ligjshme e të përshtatshme. Çdo rezultat i kontrollit duhet të dokumentohet në formate të standardizuara dhe të miratuara për:

a) Kontrollin mbi ligjshmërinë, rregullshmërinë dhe efektivitetin e shpenzimeve;

b) Vlerësimin e përputhshmërisë së reformave me hapat dhe treguesit e miratuar.

7 Të gjitha kontrollet duhet të dokumentohen përmes formateve standarde, të miratuara nga ministria përgjegjëse për financat.

8. Për më tepër, institucionet janë të detyruara të zbatojnë masa konkrete për parandalimin e konfliktit të interesit, përmes:

a) Deklaratave të interesit nga stafi përgjegjës për procesin;

b) Sistemeve të raportimit të veçantë për konfliktet e mundshme.

9. Për të garantuar integritetin dhe transparencën në zbatimin e reformave, institucionet zbatuese duhet të vendosin mekanizma funksionalë për parandalimin e mashtrimit, korrupsionit dhe parregullsive, duke përfshirë:

a) Protokolle të brendshme për sinjalizimin e shkeljeve (*whistleblowing*);

b) Mbrojtjen e sinjalizuesve në përputhje me standardet e BE-së dhe legjislacionin kombëtar në fuqi;

c) Trajnime të rregullta për stafin mbi etiken, integritetin dhe detyrimet ligjore që lidhen me administrimin e fondeve publike dhe të BE-së.

10. Institucionet janë të detyruara të ruajnë një kulturë të kontrollit të brendshëm, duke përfshirë gjithë stafin në identifikimin, parandalimin dhe raportimin e çdo devijimi nga rregullat dhe objektivat e Instrumentit RGF.

V. PROCESI I AUDITIMIT TË BRENDSHËM

1. Auditimi i brendshëm përbën një shtyllë themelore të sistemit të kontrollit të brendshëm publik dhe luan një rol të pavarur, objektiv dhe këshillues në vlerësimin e funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit në institucionet përfituese të Instrumentit për reforma dhe rritje (RGF). Ai ndihmon në identifikimin e dobësive sistemike, përmirësimin e efikasitetit të proceseve dhe garantimin e përdorimit të rregullt dhe ligjor të fondeve të BE-së.

2. Struktura përgjegjëse për harmonizimin e auditimit të brendshëm në ministrinë përgjegjëse për financat siguron koordinimin dhe funksionimin e auditimit të brendshëm për zbatimin e masave në ministritë, institucionet dhe njësitë e tjera publike përfituese.



3. Çdo institucion zbatues duhet të sigurojë shërbimin e auditimit të brendshëm sipas një prej formave të parashikuara në nenin 10 të ligjit nr. 114/2015, “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, i ndryshuar dhe në bashkëpunim me strukturën përgjegjëse për harmonizimin e auditimit të brendshëm raporton te kjo e fundit, rezultatet e auditimit në mënyrë periodike.

4. Struktura përgjegjëse për harmonizimin e auditimit të brendshëm në ministrinë përgjegjëse për financat përgatit udhëzime specifike për auditimin, në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 114/2015, “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, të ndryshuar, akteve të tjera nënligjore dhe Standardeve Globale të Auditimit të Brendshëm, të pranuar. Këto udhëzime përfshijnë të gjithë hapat, procedurat dhe dokumentacion që duhet të ndiqen për angazhimet e auditimit, raportimin e rezultateve të auditimit sipas afateve deri në ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve.

5. Institucionet zbatuese përgatisin raporte gjashtëmujore të auditimeve, të cilat dorëzohen deri më 15 qershor dhe 15 dhjetor të çdo viti te struktura përgjegjëse për harmonizimin e auditimit të brendshëm. Kjo strukturë konsolidon raportet e auditimeve dhe përgatit përmbledhjen me rezultatet e auditimeve si pjesë e raporteve periodike dhe mbështetje të kërkesave për pagesë për periudhën takuese. Ministria përgjegjëse për financat dërgon pranë Koordinatorit Kombëtar gjithë dokumentacionin për nënshkrimin e deklaratës së sigurisë brenda datës 5 korrik dhe 5 janar të çdo viti.

6. Për ndjekjen dhe zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen ministrinë e linjës dhe institucionet raportuese, duke përfshirë strukturat përgjegjëse për menaxhimin financiar, kontrollin dhe njësitë e auditimit të brendshëm në këto institucione, ministria përgjegjëse për financat, duke përfshirë Drejtorinë e Përgjithshme të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik dhe Raportimit Financiar si dhe Koordinatori Kombëtar.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I FINANCEVE
Petrit Malaj

UDHËZIM

Nr. 22, datë 14.7.2025

PËR DISA NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 16, DATË 19.10.2022, “PËR RREGULLAT PËR MASAT E VEÇANTA TË KONTROLLIT PËR TË PARANDALUAR HYRJEN DHE PËRHAPJEN BRENDË VENDIT TË XYLELLA FASTIDIOSA (WELLS ET AL)”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës dhe pikës 3, të nenit 8, të ligjit nr. 105/2016, “Për mbrojtjen e bimëve”, të ndryshuar,

UDHËZOJ:

Në udhëzimin nr. 16, datë 19.10.2022, “Për rregullat për masat e veçanta të kontrollit për të parandaluar hyrjen dhe përhapjen brenda vendit të *Xylella fastidiosa* (Wells et al)”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

Neni 1

Në nenin 2 pas shkronjës “d”, shtohet shkronja “dh”, me formulimin si vijon:

“dh) “Vektor” është insekti i rendit *Cicadomorpha* që dihet se transmeton dëmtuesin e specifikuar te bimët ose çdo insekt tjetër që dyshohet se transmeton dëmtuesin e specifikuar te bimët.

Neni 2

Në nenin 3 bëhen ndryshimet si vijon:

1. Pika 1, riformulohet me këtë përmbajtje:

“1. Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve (AKVMB) kryen vrojtime vjetore të bimëve bujtëse, si dhe të çdo specie tjetër bimë në rast dyshimi për infeksion, për zbulimin e dëmtuesit të specifikuar brenda territorit të vendit. Këto vrojtime mund të përfshijnë edhe vektorët”.

2. Pika 4, formulohet me këtë përmbajtje:

a) “4. Këto vrojtime përfshijnë mbledhjen e mostrave dhe testimin e bimëve për mbjellje dhe, nëse është e zbatueshme, edhe të vektorëve. Duke marrë parasysh udhëzimet e Autoritetit Evropian për Sigurinë Ushqimore për vrojtime statistike të besueshme dhe të bazuara në risk për *Xylella*



fastidiosa, modeli i vrojtimit dhe skema e mostrimit që do të përdoret duhet të mundësojë zbulimin, me një nivel të mjaftueshëm besueshmërie, të një niveli të ulët të pranisë së dëmtuesit të specifikuar në territorin e vendit”.

3. Pas pikës 4, shtohet pika 4.1 me formulimin si më poshtë:

b) “4.1 Në rast se prania e dëmtuesit të specifikuar konfirmohet te një vektor, në një zonë ku dëmtuesi i specifikuar nuk dihet të jetë i pranishëm, AKVMB-ja, pa vonesë, të kryejë vrojtime në një rreze prej të paktën 400 metrash përreth vendit ku është konstatuar vektori i infektuar, si dhe të marrë mostra dhe të kryejë testime të bimëve bujtëse dhe të çdo specie tjetër bimore në rast dyshimi për infeksion”.

Neni 3

Në nenin 5, paragrafi i parë, i pikës 1, formulohet me këtë përmbajtje:

“Në rast se prania e dëmtuesit të specifikuar konfirmohet zyrtarisht te bimët, AKVMB-ja, pa vonesë, përcakton një zonë të shënuar.”

Neni 4

Në nenin 6 bëhen ndryshime si vijon:

1. Shkronja “a”, e pikës 4, ndryshon me formulimin si më poshtë:

“a) të kryejë, në zonën ku prania e dëmtuesit të specifikuar u konfirmua për herë të parë, një vërtim vjetor për të paktën 1 vit, me qëllim përcaktimin nëse ndonjë bimë tjetër është infektuar dhe nëse duhen marrë masa të mëtejshme”.

2. Në shkronjën “b”, të pikës 4 shtohet një paragraf me formulimin si më poshtë:

“Vërtimi i përmendur në shkronjën “a” përfshin mostrat e mbledhura për testim duke përdorur një nga testet molekulare të listuar në aneksin III bashkëlidhur këtij udhëzimi. Modeli i vrojtimit dhe skema e mostrimit duhet të mundësojnë identifikimin, me të paktën 90% besueshmëri, të një niveli pranie prej 1/% të bimëve të infektuara”.

Neni 5

Në pikën 1, të nenit 8 bëhen ndryshime si më poshtë:

1. Shkronja “d” riformulohet me këtë përmbajtje:

“d) Bimët e specifikuar, përveç atyre të përmendura në shkronjat “c” dhe “ç”, të cilat nuk i janë nënshtruar menjëherë marrjes së mostrave dhe testimit molekular.

Bimët e specifikuar të përmendura në paragrafin e parë të kësaj shkronje, të cilat kanë rezultuar negative për praninë e dëmtuesit të specifikuar, nuk hiqen.

Përfshimisht nga paragrafi i parë i kësaj pike, AKVMB-ja mund të vendosë të mos i nënshtrohet menjëherë marrjes së mostrave dhe testimit ato bimë të specifikuar që nuk janë gjetur të infektuara nga dëmtuesi i specifikuar në atë zonë të shënuar gjatë dy viteve të fundit, bazuar në rezultatet e marrjes së mostrave dhe testimit të kryer në përputhje me paragrafin e parë të kësaj shkronje dhe vërtimet sipas nenit 11 të këtij udhëzimi. Megjithatë, këto bimë do t’u nënshtrohen vërtimeve vjetore të kryera në përputhje me nenin 11 të këtij udhëzimi”.

2. Në pikën 3 paragrafi i parë formulohet me këtë përmbajtje:

“3. Me përjashtim nga shkronjat “b”, “c” dhe “ç” të pikës 1 të këtij neni, AKVMB-ja mund të vendosë të mos i heqin bimët të specifikuar individuale që janë caktuar zyrtarisht si bimë me vlerë historike ose pemë me vlerë të veçantë shoqërore, kulturore apo mjedisore, prerja e të cilave do të kishte një ndikim të papranueshëm, ose që i nënshtrohen rregullave të veçanta kombëtare për mbrojtjen e tyre, me kusht që të jenë përmbushur të gjitha kushtet e mëposhtme”.

Neni 6

Neni 9 riformulohet me këtë përmbajtje:

“Neni 9

Masat kundër vektorëve të dëmtuesit të specifikuar

1. Në zonën e infektuar, AKVMB-ja zbaton trajtime fitosanitare të përshtatshme kundër të gjitha stadeve të popullatës së vektorit të dëmtuesit të specifikuar. Në veçanti, duhet të aplikojë këto trajtime para dhe gjatë heqjes së bimëve të përmendura në pikën 1, të nenit 8, gjatë sezonit të fluturimit të vektorëve. Këto praktika duhet të përfshijnë trajtime efikase kimike, biologjike ose



mekanike kundër vektorëve, duke marrë parasysh kushtet lokale.

2. AKVMB-ja duhet të zbatohet:

a) në zonat bujqësore, në zonën e infektuar dhe në zonën e sigurisë, praktikat bujqësore për kontrollin e popullatës së vektorit të dëmtuesit të specifikuar, në të gjitha stadet e tij, në kohën më të përshtatshme të vitit, pavarësisht nga heqja e bimëve përkatëse;

b) në zonat që nuk janë bujqësore, të paktën në zonat e infektuara, masat për kontrollin e popullatës së vektorit të dëmtuesit të specifikuar, në të gjitha stadet e tij, në kohën më të përshtatshme të vitit, pavarësisht nga heqja e bimëve përkatëse;

c) praktikat bujqësore të përmendura në shkronjën “a” dhe masat e përmendura në shkronjën “b” duhet të përfshijnë trajtime efektive kimike, biologjike ose mekanike kundër vektorëve, sipas rastit, duke marrë parasysh kushtet lokale.

Neni 7

Në nenin 10, pas pikës 2, shtohet pika 3 me formulimin si më poshtë:

“3. Në rastin kur AKVMB-ja vendos të mos asgjësojë drurin e përmendur në pikën 2 të këtij neni, ai duhet të sigurohet që druri të jetë i pastër nga gjethet dhe degët”.

Neni 8

Në nenin 15, pika 1 formulohet me këtë përmbajtje:

“1. AKVMB-ja zbaton trajtime fitosanitare të përshtatshme kundër të gjitha stadeve të popullatës së vektorit të dëmtuesit të specifikuar mbi bimët e përmendura në pikën 1, të nenit 14 të këtij udhëzimi, përpara heqjes së tyre, veçanërisht gjatë sezonit të fluturimit të vektorëve, si dhe përreth bimëve të përmendura në pikën 2, të nenit 14 të këtij udhëzimi. Këto trajtime duhet të përfshijnë metoda efikase kimike, biologjike ose mekanike kundër vektorëve, duke marrë parasysh kushtet lokale”.

Neni 9

Në nenin 16, shkronja “a”, e pikës 2, riformulohet me këtë përmbajtje:

“a) brenda një zone me përmasa prej të paktën 2 km nga kufiri i zonës së infektuar me zonën e sigurisë”.

Neni 10

Në nenin 17, pas pikës 2, shtohet pika 3 me formulimin si më poshtë:

“3. Kur AKVMB-ja vendos të mos e asgjësojë drurin e përmendur në pikën 2 të këtij neni, duhet të verifikojë që druri të jetë i pastër nga gjethet dhe degët”.

Neni 11

Në nenin 19 janë bërë ndryshime si vijon:

1. Shkronjat “b” dhe “c” riformulohet me këtë përmbajtje:

“b) këto bimë të specifikuara mbillen ose shartohen në zonat e infektuara, por jashtë zonës së përmendur në shkronjën “a”, pikën 2, të nenit 16 të këtij udhëzimi, dhe preferohet të jenë të kultivarëve që janë vlerësuar si rezistentë ose tolerantë ndaj dëmtuesit të specifikuar, ose të jenë të së njëjtës specie bimësh që janë testuar dhe rezultuar të pastra nga dëmtuesi i specifikuar, mbi bazën e vrojtimeve të kryera në zonën e infektuar të paktën gjatë dy viteve të fundit;

c) këto bimë të specifikuara i përkasin të njëjtës specie bimore që është testuar dhe kanë rezultuar të pastra nga dëmtuesi i specifikuar, mbi bazën e veprimtarive të vrojtimit të kryera për të paktën dy vitet e fundit në përputhje me nenin 11, dhe rimbillen në zonat e infektuara të përcaktuara për qëllime çrrënjësje”.

2. Pas shkronjës “c”, shtohet shkronja “ç”, me formulimin si më poshtë:

“ç) bimë të specifikuara, përveç atyre të përmendura në shkronjën “b” të këtij neni, mund të mbillen për qëllime shkencore, me kusht që të mbillen jashtë zonave të përmendura në paragrafin e parë, të shkronjës “a”, të pikës 2, të nenit 16 të këtij udhëzimi”.

Neni 12

Në nenin 20, shkronja “a”, zëvendësohet me formulimin si vijon:

“a) bimët e specifikuara janë kultivuar gjatë gjithë ciklit të tyre të prodhimit në një vend që është miratuar në përputhje me nenin 25 të këtij udhëzimi



ose kanë qenë të pranishme në një vend të tillë për të paktën 1 vit”.

Neni 13

Në nenin 24, shkronja “a” riformulohet me këtë përmbajtje:

“a) Bimët e specifikuar janë kultivuar në një vend që i përket një operatori të regjistruar në përputhje me nenin 6/1, të ligjit nr. 105/2016, “Për mbrojtjen e bimëve”, të ndryshuar, dhe në rastin e një zone të infektuar, vendi përmbush kërkesat e nenit 19 të këtij udhëzimi”.

Neni 14

Në nenin 25, shkronjat “b” dhe “c” riformulohen me këtë përmbajtje:

“b) është një vendndodhje fizikisht e mbrojtur kundër dëmtuesit të specifikuar dhe transmetuesve të tij;

c) i është nënshtruar të paktën dy inspektimeve vjetore nga AKVMB-ja në kohën më të përshtatshme, ku inspektimi i fundit përfshin marrjen e mostrave dhe testimin sa më afër kohës së lëvizjes”.

Neni 15

Në nenin 26, paragrafi i parë, i pikës 2, formulohet si më poshtë:

“2. Përjashtimisht nga pika 1, bimët për mbjellje, përveç farërave, të *Coffea*, *Lavandula dentata* L., *Nerium oleander* L., *Olea europaea* L., *Polygala myrtifolia* L. dhe *Prunus dulcis* (Mill.) D.A. Webb, mund të lëvizin për herë të parë brenda vendit vetëm kur plotësohen kushtet e mëposhtme”.

Neni 16

Në nenin 28, shkronja “b” riformulohet me këtë përmbajtje:

“b) Në rastin kur lëvizin brenda zonës së sigurisë, ose nga zona e sigurisë në zonën e infektuar, pranë kodit të gjurmueshmërisë të përmendur në shkronjën “c”, të pikës 1, të pjesës A, të aneksit IV, të urdhrit nr. 274, datë 5.5.2023, “Për procedurën, kushtet dhe kriteret që duhet të plotësojë një operator për t’u miratuar për lëshimin e pasaportës bimore, si dhe rastet e heqjes së miratimit”, duhet të përfshihet shënimi “Zona e Sigurisë – XYLEFA”.

Neni 17

Në nenin 29, shkronjat “a” dhe “ç” riformulohet me këtë përmbajtje:

“a) Autoriteti Kompetent i Mbrojtjes së Bimëve të vendit tjetër, përveç atyre të BE-së i ka komunikuar me shkrim Komisionit Evropian se dëmtuesi i specifikuar dihet se nuk është i pranishëm në vend, dhe kjo deklaratë është publikuar në faqen zyrtare të BE-së “*Deklarata nga vendet jo anëtare të BE-së në lidhje me statusin e Xylella fastidiosa*”. Në rast se një deklaratë e tillë nuk është e publikuar, autoriteti kompetent i vendit tjetër njofton me shkrim Autoritetin Kompetent të Mbrojtjes së Bimëve në Ministri të vendit tonë, se dëmtuesi i specifikuar dihet se nuk është i pranishëm në vend, bazuar në inspektim, marrje mostrash dhe testim molekular nga autoriteti kompetent, duke përdorur një test të listuar në aneksin III bashkëlidhur këtij udhëzimi, dhe në përputhje me ISPM nr. 4 (*) dhe duke marrë në konsideratë udhëzimet e autoritetit për vrojtime statistikisht të sakta dhe të bazuara në risk për *Xylella fastidiosa*, përcaktimi i skemës së vrojimit dhe mostrimit të përdorura janë në gjendje të identifikojnë një nivel të mjaftueshëm besueshmërie, një nivel të ulët të pranisë së dëmtuesit të specifikuar.

Për vendet e BE-së statusi në lidhje me *Xylella fastidiosa*, do të verifikohet në faqen zyrtare të BE-së për *Xylella fastidiosa*”: (*) ISPM nr. 4 “Kërkesat për krijimin e zonave të pastra nga dëmtuesit”.

ç) Bimët për mbjellje, përveç farave, të llojeve *Coffea* L., *Lavandula angustifolia* Mill., *Lavandula dentata* L., *Lavandula x intermedia* Emeric ex Loisel., *Lavandula latifolia* Medik., *Lavandula stoechas* L., *Nerium oleander* L., *Olea europaea* L., *Polygala myrtifolia* L., *Prunus dulcis* (Mill.) D.A. Webb dhe *Salvia rosmarinus* Spenn. që janë kultivuar në një vend që i nënshtrohet inspektimit vjetor nga autoriteti kompetent, me marrje mostrash dhe testime, të listuar në aneksin III të këtij udhëzimi, kryer në kohët e përshtatshme për praninë e dëmtuesit të specifikuar, duke përdorur një skemë mostrimi që është në gjendje të identifikojë me të paktën 80% besueshmëri me një nivel të pranisë së bimëve të infektuara prej 1%”.



Neni 18

Në nenin 30, shkronjat “a”, “c” dhe “d”, riformulohet me këtë përmbajtje:

“a) bimët bujtëse e kanë origjinën nga një zonë e cila është shpallur e pastër nga dëmtuesi i specifikuar nga organizata kombëtare për mbrojtjen e bimëve përkatëse, në përputhje me ISPM nr. 4 dhe mbi bazën e inspektimeve zyrtare të kryera përmes marrjes së mostrave dhe testimeve, duke përdorur një test të listuar në aneksin III bashkëlidhur këtij udhëzimi, dhe duke marrë në konsideratë udhëzimet e autoritetit për inspektime statistikisht të besueshme dhe të bazuar në risk për *Xylella fastidiosa*, skema e inspektimit dhe marrjes së mostrave duhet të jenë në gjendje të identifikojnë, me një nivel të mjaftueshëm besueshmërie, një nivel të ulët të pranisë së dëmtuesit të specifikuar;

c) bimët bujtëse shoqërohen me një certifikatë fitosanitare që deklaron se ato kanë kaluar të gjithë jetën e tyre në zonën e përmendur në shkronjën “a” të këtij neni, me referencë specifike për emrin e asaj zone;

d) Bimët për mbjellje, përveç farave, të *Coffea* L., *Lavandula angustifolia* Mill., *Lavandula dentata* L., *Lavandula x intermedia* Emeric ex Loisel., *Lavandula latifolia* Medik., *Lavandula stoechas* L., *Nerium oleander* L., *Olea europaea* L., *Polygala myrtifolia* L., *Prunus dulcis* (Mill.) D.A. Webb dhe *Salvia rosmarinus* Spenn., janë kultivuar në një vend i cili i nënshtrohet inspektimit vjetor nga autoriteti kompetent, me marrje mostrash dhe testime të listuar në aneksin III bashkëlidhur këtij udhëzimi, të kryera në kohët e përshtatshme mbi këto bimë për praninë e dëmtuesit të specifikuar, duke përdorur një skemë marrje mostrash që është në gjendje të identifikojë me të paktën 80% besueshmëri, një nivel pranie të bimëve të infektuara prej 1%”.

Neni 19

Në nenin 31 janë bërë ndryshime si vijon:

Në pikën 1, shkronja “c”, nënndarja “ii” riformulohet me përmbajtjen e mëposhtme:

“ii) emri ose kodi i vendndodhjes/vendeve të prodhimit pa dëmtues”.

Në pikën 2, shkronja “c”, nënndarja “ii” riformulohet me përmbajtjen e mëposhtme:

“ii) emri ose kodi i vendndodhjes/ve të prodhimit pa dëmtues”.

Neni 20

Në nenin 33, pika 2 riformulohet me këtë përmbajtje:

“2. Kontrollë të tilla do të kryhen, të paktën, në vendndodhje të tilla si rrugët, aeroportet dhe portet, ku bimët e specifikuara zhvendosen nga zonat e infektuara në zonat e sigurisë ose në pjesë të tjera të territorit të vendit”.

Neni 21

Në nenin 36, pikat 2, 3 dhe 4 shfuqizohen.

Neni 22

1. Aneksi I dhe aneksi II, që i bashkëngjiten dhe janë pjesë përbërëse e udhëzimit nr. 16, datë 19.10.2022, “Për rregullat për masat e veçanta të kontrollit për të parandaluar hyrjen dhe përhapjen brenda vendit të *Xylella fastidiosa* (Wells et al)”, të ndryshuar, zëvendësohen me aneksin I dhe aneksin II bashkëngjitur këtij udhëzimi.

2. Në aneksin III që i bashkëngjitet dhe është pjesë përbërëse e udhëzimit nr. 16, datë 19.10.2022, “Për rregullat për masat e veçanta të kontrollit për të parandaluar hyrjen dhe përhapjen brenda vendit të *Xylella fastidiosa* (Wells et al)”, të ndryshuar, bëhen ndryshime sipas aneksit III bashkëngjitur këtij udhëzimi.

Neni 23

Ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data 1 gusht 2025.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL
Anila Denaj



Aneksi I

“Aneksi I

Lista e bimëve që dihet se janë të ndjeshme
ndaj një ose më shumë nënspecieve të
dëmtuesit të specifikuar (“bimët bujtëse”)

Acacia Mill.
Acer L.
Adenocarpus lainzii (Castrov.) Castrov.
Albizia julibrissin Durazz.
Alnus rhombifolia Nutt.
Amaranthus retroflexus L.
Ambrosia L.
Ampelopsis arborea (L.) Koehne
Ampelopsis brevipedunculata (Maxim.) Trautv.
Ampelopsis cordata Michx.
Anthyllis barba-jovis L.
Anthyllis hermanniae L.
Arbutus unedo L.
Argyranthemum frutescens (L.) Sch.Bip.
Artemisia L.
Asparagus acutifolius L.
Athyrium filix-femina (L.) Roth
Baccharis L.
Berberis thunbergii DC.
Brassica L.
Calicotome spinosa (L.) Link
Calicotome villosa (Poir.) Link
Callicarpa americana L.
Callistemon citrinus (Curtis) Skeels
Calluna vulgaris (L.) Hull
Calocephalus brownii (Cass.) F.Muell.
Carya Nutt.
Castanea sativa Mill.
Catharanthus roseus (L.) G.Don
Celtis occidentalis L.
Cercis canadensis L.
Cercis occidentalis Torr.
Cercis siliquastrum L.
Chamaecrista fasciculata (Michx.) Greene
Chenopodium album L.
Chionanthus L.
× Chitalpa tashkentensis T. S. Elias & Wisura
Cistus L.
Citrus L.
Clematis cirrhosa L.
Clematis vitalba L.
Clinopodium nepeta (L.) Kuntze
Coelorachis cylindrica (Michx.) Nash

Coffea L.
Conium maculatum L.
Convolvulus cneorum L.
Coprosma repens A.Rich.
Cornus sanguinea L.
Coronilla L.
Cortaderia selloana (Schult. & Schult.f.) Asch. & Graebn.
Cyperus eragrostis Lam.
Cytisus Desf.
Digitaria Haller
Dimorphotheca ecklonis (DC.) Norl.
Dimorphotheca fruticosa (L.) Norl.
Diospyros kaki L.f.
Diplocyclos palmatus (L.) C.Jeffrey
Dittrichia viscosa (L.) Greuter
Dodonaea viscosa (L.) Jacq.
Echium plantagineum L.
Elaeagnus angustifolia L.
Elaeagnus × submacrophylla Servett.
Encelia farinosa A.Gray ex Torr.
Eremophila maculata (Ker Gawler) F. von Müller.
Erica cinerea L.
Erigeron L.
Eriophthalmus africanus L.
Erodium moschatum (L.) L'Hérit.
Erysimum L.
Euphorbia chamaesyce L.
Euphorbia terracina L.
Euryops chrysanthemoides (DC.) B.Nord.
Euryops pectinatus (L.) Cass.
Fagus crenata Blume
Fallopia japonica (Houtt.) Ronse Decr.
Fatsia japonica (Thunb.) Decne. & Planch.
Ficus carica L.
Frangula alnus Mill.
Fraxinus L.
Gazania rigens (L.) Gaertn.
Genista L.
Ginkgo biloba L.
Gleditsia triacanthos L.
Grevillea juniperina Br.
Grevillea rosmarinifolia A. Cunn.
Hebe Comm. ex Juss.
Helianthus L.
Helichrysum Mill.
Heliotropium europaeum L.
Hemerocallis L.
Hevea brasiliensis (Willd. ex A.Juss.) Müll.Arg.
Hibiscus L.



Humulus scandens (Lour.) Merr.
Hypericum androsaemum L.
Hypericum perforatum L.
Ilex aquifolium L.
Ilex vomitoria Sol. ex Aiton
Iva annua L.
Jacaranda mimosifolia D. Don
Jacobaea maritima (L.) Pelser & Meijden
Juglans L.
Juniperus ashei J. Buchholz
Koelreuteria bipinnata Franch.
Lagerstroemia L.
Laurus nobilis L.
Lavandula L.
Lavatera cretica L.
Ligustrum lucidum W.T.Aiton.
Liquidambar styraciflua L.
Lonicera implexa Soland.
Lonicera japonica Thunb.
Lonicera perichlymenum L.
Lupinus aridorum McFarlin ex Beckner
Lupinus villosus Willd.
Magnolia grandiflora L.
Magnolia x soulangeana Soul.-Bod.
Mallotus paniculatus (Lam.) Müll.Arg.
Medicago arborea L.
Medicago sativa L.
Mentha suaveolens Ehrh.
Metrosideros Banks ex Gaertn.
Mimosa L.
Modiola caroliniana (L.) G. Don
Morus L.
Myoporum insulare R.Br.
Myoporum laetum G. Forst.
Myrtus communis L.
Nandina domestica Murray
Neptunia lutea (Leavenw.) Benth.
Nerium oleander L.
Olea L.
Parthenocissus quinquefolia (L.) Planch.
Paspalum dilatatum Poir.
Pelargonium L'Hér. ex Aiton
Perovskia abrotanoides Kar.
Persea americana Mill.
Phagnalon saxatile (L.) Cass.
Phillyrea angustifolia L.
Phillyrea latifolia L.
Phlomis fruticosa L.
Phlomis italica L.
Phoenix reclinata Jacquin

Phoenix roebelenii O'Brien
Pinus taeda L.
Pistacia vera L.
Plantago lanceolata L.
Platanus L.
Pluchea odorata (L.) Cass.
Polygala grandiflora Wight
Polygala myrtifolia L.
Prunus L.
Psidium L.
Pteridium aquilinum (L.) Kuhn
Pyracantha coccinea M. Roem.
Pyrus L.
Quercus L.
Ratibida columnifera (Nutt.) Wooton & Standl.
Retama monosperma (L.) Boiss.
Rhamnus alaternus L.
Rhamnus L.
Rhus L.
Robinia pseudoacacia L.
Rosa L.
Rubus L.
Ruta chalepensis L.
Ruta graveolens L.
Salvia apiana Jeps.
Salvia mellifera Greene
Salvia officinalis L.
Salvia rosmarinus Spenn.
Sambucus L.
Santolina chamaecyparissus L.
Santolina magonica (O.Bolòs, Molin. & P.Monts.)

Romo

Sapindus saponaria L.
Sassafras L. ex Nees
Scabiosa atropurpurea var. *maritima* L.
Senecio inaequidens DC.
Setaria magna Griseb.
Solidago fistulosa Mill.
Solidago virgaurea L.
Sorghum halepense (L.) Pers.
Spartium L.
Stewartia pseudocamellia Maxim.
Strelitzia reginae Aiton
Streptocarpus Lindl.
Symphotrichum divaricatum (Nutt.) G.L.Nesom
Syringa vulgaris L.
Teucrium capitatum L.
Thymus vulgaris L.
Trifolium repens L.
Ulex L.



Ulmus L.
Vaccinium L.
Viburnum tinus L.
Vinca L.
Vitex agnus-castus L.
Vitis L.
Westringia fruticosa (Willd.) Druce
Westringia glabra R.Br.
Xanthium strumarium L.
 ”

Aneksi II

“Aneksi II

Lista e bimëve që dihet se janë të ndjeshme
 ndaj nënspecieve specifike të dëmtuesit të
 specifikuar (bimët e specifikuara)

Bimët e specifikuara të ndjeshme ndaj
Xylella fastidiosa nënspecie *fastidiosa*

Acer L.
Ambrosia artemisiifolia L.
Calicotome spinosa (L.) Link
Cercis occidentalis Torr.
Cistus monspeliensis L.
Citrus limon (L.) Osbeck
Citrus paradisi Macfad.
Citrus reticulata Blanco
Citrus sinensis (L.) Osbeck
Coffea L.
Elaeagnus angustifolia L.
Erysimum L.
Ficus carica L.
Fraxinus angustifolia Vahl
Genista lucida L.
Juglans regia L.
Liquidambar styraciflua L.
Lupinus aridorum McFarlin ex Beckner
Magnolia grandiflora L.
Medicago sativa L.
Metrosideros Banks ex Gaertn.
Morus L.
Myrtus communis L.
Nerium oleander L.
Pelargonium graveolens L'Hér.
Pluchea odorata (L.) Cass.
Polygala myrtifolia L.
Prunus L.
Psidium L.
Quercus ilex L.
Rhamnus alaternus L.

Rubus ideaus L.
Rubus rigidus Sm.
Rubus ursinus Cham. & Schldl.
Ruta chalepensis L.
Salvia rosmarinus Spenn.
Sambucus L.
Spartium junceum L.
Strelitzia reginae Aiton
Streptocarpus Lindl.
Teucrium capitatum L.
Ulex europaeus L.
Ulmus americana L.
Vaccinium corymbosum L.
Vinca L.
Vitis L.

Bimët e specifikuara të ndjeshme ndaj
 nënspecies *Xylella fastidiosa* multiplex

Acacia Mill.
Acer granatense Boiss.
Acer griseum (Franch.) Pax
Acer pseudoplatanus L.
Acer rubrum L.
Adenocarpus lainzii (Castrov.) Castrov.
Alnus rhombifolia Nutt.
Ambrosia L.
Ampelopsis cordata Michx.
Anthyllis barba-jovis L.
Anthyllis hermanniae L.
Arbutus unedo L.
Argyranthemum frutescens (L.) Sch.Bip.
Artemisia L.
Asparagus acutifolius L.
Athyrium filix-femina (L.) Roth
Baccharis balimifolia L.
Berberis thunbergii DC.
Calicotome spinosa (L.) Link
Calicotome villosa (Poir.) Link
Callistemon citrinus (Curtis) Skeels
Calluna vulgaris (L.) Hull
Calocephalus brownii (Cass.) F.Muell
Carya Nutt.
Castanea sativa Mill.
Celtis occidentalis L.
Cercis canadensis L.
Cercis occidentalis Torr.
Cercis siliquastrum L.
Chenopodium album L.
Chionanthus L.
Cistus L.



- Clematis cirrhosa* L.
Clematis vitalba L.
Clinopodium nepeta (L.) Kuntze
Convolvulus cneorum L.
Coprosma repens A.Rich.
Cornus sanguinea L.
Coronilla L.
Cytisus Desf.
Dimorphantheca ecklonis (DC.) Norl.
Dimorphantheca fruticosa (L.) Norl.
Dittrichia viscosa (L.) Greuter
Dodonaea viscosa (L.) Jacq.
Echium plantagineum L.
Elaeagnus angustifolia L.
Elaeagnus × submacrophylla Servett.
Encelia farinosa A.Gray ex Torr.
Erica cinerea L.
Erigeron L.
Eriosephalus africanus L.
Erodium moschatum (L.) L'Hérit.
Euryops chrysanthemoides (DC.) B.Nord.
Euryops pectinatus (L.) Cass.
Fallopia japonica (Houtt.) Ronse Decr.
Ficus carica L.
Frangula alnus Mill.
Fraxinus L.
Gazania rigens (L.) Gaertn.
Genista L.
Ginkgo biloba L.
Gleditsia triacanthos L.
Grevillea juniperina Br.
Grevillea rosmarinifolia A. Cunn.
Hebe Comm. ex Juss.
Helianthus L.
Helichrysum Mill.
Hibiscus syriacus L.
Hypericum androsaemum L.
Hypericum perforatum L.
Ilex aquifolium L.
Iva annua L.
Jacobaea maritima (L.) Pelser & Meijden
Koeleria bipinnata Franch.
Lagerstroemia L.
Laurus nobilis L.
Lavandula L.
Lavatera cretica L.
Liquidambar styraciflua L.
Lonicera implexa Soland.
Lonicera japonica Thunb.
Lonicera periclymenum L.
Lupinus aridorum McFarlin ex Beckner
Lupinus villosus Willd.
Magnolia grandiflora L.
Magnolia × soulangeana Soul.-Bod.
Medicago arborea L.
Medicago sativa L.
Mentha suaveolens Ehrh.
Metrosideros Banks ex Gaertn.
Myoporum laetum G.Forst.
Myrtus communis L.
Nerium oleander L.
Olea L.
Pelargonium L'Hér. ex Aiton
Perovskia abrotanoides Kar.
Phagnalon saxatile (L.) Cass.
Phillyrea angustifolia L.
Phlomis fruticosa L.
Phlomis italica L.
Pistacia vera L.
Plantago lanceolata L.
Platanus L.
Polygala grandiflora Wight
Polygala myrtifolia L.
Prunus L.
Pteridium aquilinum (L.) Kuhn
Quercus L.
Ratibida columnifera (Nutt.) Wooton & Standl.
Retama monosperma (L.) Boiss.
Rhamnus alaternus L.
Rhamnus L.
Robinia pseudoacacia L.
Rosa L.
Rubus L.
Ruta graveolens L.
Salvia mellifera Greene
Salvia officinalis L.
Salvia rosmarinus Spenn.
Sambucus L.
Santolina chamaecyparissus L.
Santolina magonica (O.Bolòs, Molin. & P.Monts.)
 Romo
Sapindus saponaria L.
Scabiosa atropurpurea var. *maritima* L.
Senecio inaequidens DC.
Solidago virgaurea L.
Spartium L.
Strelitzia reginae Aiton
Syringa vulgaris L.
Ulex L.
Ulmus L.



Vaccinium L.
Viburnum tinus L.
Vinca L.
Vitex agnus-castus L.
Westringia fruticosa (Willd.) Druce
Xanthium strumarium L.

**Bimët të specifikuara të ndjeshme ndaj
 nënspesie *Xylella fastidiosa* pauca**

Acacia Mill.
Amaranthus retroflexus L.
Asparagus acutifolius L.
Catharanthus roseus (L.) G.Don
Chenopodium album L.
Cistus albidus L.
Cistus creticus L.
Citrus L.
Coffea L.
Dimorphotheca fruticosa (L.) Norl.
Dodonaea viscosa (L.) Jacq.
Elaeagnus angustifolia L.
Eremophila maculata (Ker Gawler) F. von Müller.
Erigeron L.
Euphorbia chamaesyce L.
Euphorbia terracina L.
Genista hirsuta Vahl.

Grevillea juniperina Br.
Hebe Comm. ex Juss.
	E 951	Aspartam	600		përrjashtohet cydr jakościowy, perry jakościowe, cydr lodowy, perry lodowe
	E 954	Sakarinë dhe kripërat e saj të Na, K dhe Ca	80	(52)	përrjashtohet cydr jakościowy, perry jakościowe, cydr lodowy, perry lodowe
	E 955	Sukralozë	50		përrjashtohet cydr jakościowy, perry jakościowe, cydr lodowy, perry lodowe
	E 959	Neohesperidin DC	20		përrjashtohet cydr jakościowy, perry jakościowe, cydr lodowy, perry lodowe
	E 961	Neotam	20		përrjashtohet cydr jakościowy, perry jakościowe, cydr lodowy, perry lodowe
	E 962	Kripë aspartame-acesulfami	350	(11)a (49) (50)	përrjashtohet cydr jakościowy, perry jakościowe, cydr lodowy, perry lodowe
	E 969	Advantam	6		përrjashtohet cydr jakościowy, perry jakościowe, cydr lodowy, perry lodowe
	E 999	Ekstrakt i Quillaia	200	(45)	përrjashtohet cidre bouché, cydr jakościowy, perry jakościowe, cydr lodowy, perry lodowe

- Hyrja për grupin II, grupin III, E 104, E 110, E 124, E 160d, E 242 dhe E 1105 në kategorinë e ushqimit në pikën 14.2.4 zëvendësohet si më poshtë:

	Grupi II	Ngjyresit në sasi e mjaftueshme	<i>Sasi e mjaftueshme</i>		përrjashtohet verë frutash owocowe jakościowe
	Grupi III	Ngjyresit me limitin maksimal të kombinuar	200		përrjashtohet verë frutash owocowe jakościowe
	E 104	E verdha kinoline	25	(64)	përrjashtohet verë frutash owocowe jakościowe
	E 110	E verdha e perëndimit të diellit FCF/e verdhë portokalli S	10	(64)	përrjashtohet verë frutash owocowe jakościowe
	E 124	Ponceau 4R, Cokineal i kuq A	1	(61)	përrjashtohet verë frutash owocowe jakościowe
	E 160d	Likopen	10		përrjashtohet verë frutash owocowe jakościowe
	E 242	Karbonat dimetilik	250	(24)	vetëm për verë frutash, verë frutash me përmbajtje të reduktuar të alkoolit dhe verë frutash cilësore, verë frutash liker, verë frutash e aromatizuar, verë nga lëngu i rrushit, verë me lëng rrushi e aromatizuar, verë frutash me pak alkool dhe verë frutash të aromatizuar me pak alkool
	E 1105	Lisozima	<i>Sasi e mjaftueshme</i>		vetëm verë me lëng rrushi, verë me lëng rrushi të aromatizuar, verë frutash me pak alkool dhe verë frutash të aromatizuar me pak alkool



Kategoria në pikën 14.2.5 ndryshohet si vijon:

- hyrja për grupin II zëvendësohet si më poshtë:

	Grupi II	Ngjyruesit në <i>sasi të mjaftueshme</i>	<i>Sasi e mjaftueshme</i>		përveç miód pitny jakościowy?
--	----------	--	---------------------------	--	-------------------------------

- Hyrja e mëposhtme për E 150a shtohet pas hyrjes për grupin II:

	E 150a	Karamel i thjeshtë	<i>Sasi e mjaftueshme</i>		miód pitny jakościowy mund të përmbajë vetëm E 150a të prodhuar nga mjalti
--	--------	--------------------	---------------------------	--	--

Kategoria në pikën 14.2.6 ndryshohet si më poshtë:

- Hyrja për grupin II, grupin III, E 104, E 110, E 123, E 124, E 150a-d, E 338-452, dhe E 473-474 në kategorinë e ushqimit 14.2.6 zëvendësohet me:

	Grupi II	Ngjyruesit në sasi të mjaftueshme	<i>Sasi e mjaftueshme</i>		përveç: pijeve alkoolike të kategorisë rum, Whisky, pije alkoolike e përftuar nga drithërat, pije alkoolike e përftuar nga vera, Pije alkoolike e përftuar nga vera e distiluar, raki rrushi, raki frutash përveç rrushit, pije alkoolike e distiluar nga rrushi i thate, pije alkoolike e distiluar nga frutat, pije alkoolike e distiluar nga patatja, pije alkoolike e distiluar nga lëngu i fermentuar i mollës dhe dardhës, Pije alkoolike e distiluar nga mjalti, Pije alkoolike e distiluar nga sedimentet e verës, <i>Spirit Birrë</i> - Pije alkoolike e distiluar nga buka - Pije alkoolike e distiluar nga lëngu i pemës së betulles dhe pemës së panjës, pije alkoolike e distiluar nga artiçoku i Jerusalemit, Vodka, pije alkoolike (e plotësuar me emrin e frutës) e përftuar nga macerimi dhe distilimi, pije alkoolike Geist (e plotësuar me emrin e frutës apo materialit të përdorur), Xhin i Londrës, Sambuka, Maraskino,
	Grupi III	Ngjyruesit me kufirin maksimal të kombinuar	200	(87)	përveç: pijeve alkoolike të kategorisë rum, Whisky, pije alkoolike e përftuar nga drithërat, pije alkoolike e përftuar nga vera, Pije alkoolike e përftuar nga vera e distiluar, raki rrushi, raki frutash përveç rrushit, pije alkoolike e distiluar nga rrushi i thate, pije alkoolike e distiluar nga frutat, pije alkoolike e distiluar nga patatja, pije alkoolike e distiluar nga lëngu i fermentuar i mollës dhe dardhës, Pije alkoolike e distiluar nga mjalti, Pije alkoolike e distiluar nga sedimentet e verës, <i>Spirit Birrë</i> - Pije alkoolike e distiluar nga buka - Pije alkoolike e distiluar nga lëngu i pemës së betulles dhe pemës së panjës, pije alkoolike e distiluar nga artiçoku i Jerusalemit, Vodka, pije alkoolike (e plotësuar me emrin e frutës) e përftuar nga macerimi dhe distilimi, pije alkoolike Geist (e plotësuar me emrin e frutës apo materialit të përdorur), Xhin i Londrës, Sambuka, Maraskino
	E 104	E verdhë kinoline	180	(61)	përveç: pijeve alkoolike të kategorisë rum, Whisky, pije alkoolike e përftuar nga drithërat, pije alkoolike e përftuar nga vera, Pije alkoolike e përftuar nga vera e distiluar, raki rrushi, raki frutash përveç rrushit, pije alkoolike e distiluar nga rrushi i thate, pije alkoolike e distiluar nga frutat, pije alkoolike e distiluar nga patatja, pije alkoolike e distiluar nga lëngu i fermentuar i mollës dhe dardhës, pije alkoolike e distiluar nga mjalti,



					Pije alkoolike e distiluar nga sedimentet e verës, <i>Spirit Birrë</i> - Pije alkoolike e distiluar nga buka - Pije alkoolike e distiluar nga lëngu i pemës së betulles dhe pemës së panjës, pije alkoolike e distiluar nga artiçoku i Jerusalemit, Vodka, pije alkoolike (e plotësuar me emrin e frutës) e përftuar nga macerimi dhe distilimi, pije alkoolike Geist (e plotësuar me emrin e frutës apo materialit të përdorur), Xhin i Londrës, Sambuka, Maraskino
	E 110	E verdha e perëndimit të diellit FCF/ e verdhë portokalli S	100	(61)	përveç: pijeve alkoolike të kategorisë rum, Whisky, pije alkoolike e përftuar nga drithërat, pije alkoolike e përftuar nga vera, Pije alkoolike e përftuar nga vera e distiluar, raki rrushi, raki frutash përveç rrushit, pije alkoolike e distiluar nga rrushi i thate, pije alkoolike e distiluar nga frutat, pije alkoolike e distiluar nga patatja, pije alkoolike e distiluar nga lëngu i fermentuar i mollës dhe dardhës, Pije alkoolike e distiluar nga mjalti, Pije alkoolike e distiluar nga sedimentet e verës, <i>Spirit Birrë</i> - Pije alkoolike e distiluar nga buka - Pije alkoolike e distiluar nga lëngu i pemës së betulles dhe pemës së panjës, pije alkoolike e distiluar nga artiçoku i Jerusalemit, Vodka, pije alkoolike (e plotësuar me emrin e frutës) e përftuar nga macerimi dhe distilimi, pije alkoolike Geist (e plotësuar me emrin e frutës apo materialit të përdorur), Xhin i Londrës, Sambuka, Maraskino
	E 123	Amarant	30		përveç: pijeve alkoolike të kategorisë rum, Whisky, pije alkoolike e përftuar nga drithërat, pije alkoolike e përftuar nga vera, Pije alkoolike e përftuar nga vera e distiluar, raki rrushi, raki frutash përveç rrushit, pije alkoolike e distiluar nga rrushi i thate, pije alkoolike e distiluar nga frutat, pije alkoolike e distiluar nga patatja, pije alkoolike e distiluar nga lëngu i fermentuar i mollës dhe dardhës, pije alkoolike e distiluar nga mjalti, pije alkoolike e distiluar nga sedimentet e verës, <i>Spirit Birrë</i> , pije alkoolike e distiluar nga buka, Pije alkoolike e distiluar nga lëngu i pemës së betulles dhe pemës së panjës, pije alkoolike e distiluar nga artiçoku i Jerusalemit, Vodka, pije alkoolike (e plotësuar me emrin e frutës) e përftuar nga macerimi dhe distilimi, pije alkoolike Geist (e plotësuar me emrin e frutës apo materialit të përdorur), Xhin i Londrës, Sambuka, Maraskino
	E 124	Ponceau 4R, Cochineal i Kuq A	170	(61)	përveç: pijeve alkoolike të kategorisë rum, Whisky, pije alkoolike e përftuar nga drithërat, pije alkoolike e përftuar nga vera, Pije alkoolike e përftuar nga vera e distiluar, raki rrushi, raki frutash përveç rrushit, pije alkoolike e distiluar nga rrushi i thate, pije alkoolike e distiluar nga frutat, pije alkoolike e distiluar nga patatja, pije alkoolike e distiluar nga lëngu i fermentuar i mollës dhe dardhës, pije alkoolike e distiluar nga mjalti, Pije alkoolike e distiluar nga sedimentet e verës, <i>Spirit Birrë</i> - Pije alkoolike e distiluar nga buka - Pije alkoolike e distiluar nga lëngu i pemës së betulles dhe pemës së panjës, pije alkoolike e distiluar nga artiçoku i Jerusalemit, Vodka, pije alkoolike (e



					plotësuar me emrin e frutës) e përfutur nga macerimi dhe distilimi, pije alkoolike Geist (e plotësuar me emrin e frutës apo materialit të përdorur), Xhin i Londrës, Sambuka, Maraskino,
	E 150a-d	Karamel	<i>Sasi e mjaftueshme</i>		Përveç: pijeve alkoolike të kategorive; Vodka, pije alkoolike (e plotësuar me emrin e frutës) e përfutur nga macerimi dhe distilimi, pije alkoolike Geist (e plotësuar me emrin e frutës apo lëndë së parë të përdorur), Xhin i Londrës, Sambuka, Maraskino dhe Mistrà. Pija alkoolike Whisky mund të përmbajë vetëm E 150a. Pijet alkoolike të kategorive; Rum, Pijet alkoolike të përfutur nga drithërat, pije alkoolike e përfutur nga vera, pije alkoolike e përfutur nga vera e distiluar, raki rrushi, raki frutash përveç rrushit, pije alkoolike e distiluar nga rrushi i thatë, pije alkoolike e distiluar nga lëngu i fermentuar i mollës dhe dardhës, pije alkoolike e distiluar nga mjalti, pije alkoolike e distiluar nga sedimentet e verës, <i>Spirit Birrë</i> -Pije alkoolike e distiluar nga buka-Pije alkoolike e distiluar nga lëngu i pemës së betulles dhe pemës së panjës, pije alkoolike e distiluar nga artichoku i Jerusalemit mund të përmbajnë vetëm karamel të shtuar për rregullimin e ngjyrës.
	E 338-452	Acid fosforik, fosfate, difosfate, trifosfate dhe polifosfate	1 000	(1) (4)	përveç: pijeve alkoolike të kategorisë Whisky.
	E 473-474	Esteret e saharozës së acideve yndyrore – sukrogliceridet	5 000	(1)	përveç: pijeve alkoolike të kategorisë Whisky.

Kategoria në pikën 14.2.7 ndryshohet si vijon:

- hyrja e dytë për E 123 në kategorinë e ushqimit në pikën 14.2.7.1 zëvendësohet me:

E 123	Amaranth	30		Vetëm për aperitivë me bazë vere
-------	----------	----	--	----------------------------------

Kategoria në pikën 14.2.8 ndryshohet si vijon:

- Hyrja për kategorinë e ushqimit në pikën 14.2.8 “Pije të tjera alkoolike”, duke përfshirë përzierjet e pijeve alkoolike me pije joalkoolike dhe pije alkoolike me më pak se 15% alkool’ zëvendësohet me:

14.2.8	Pije të tjera alkoolike, duke përfshirë përzierjet e pijeve alkoolike me pije joalkoolike dhe pije të tjera alkoolike të bazuara në alkool të distiluar me forcë alkoolike më pak se 15% në volum
--------	---

- Hyrja për grupin III, E 104, E 110, E 123, E 124, E 160b(ii), E 200-202, E 210-213, E 220-228, E 242, E 405, E 432-436, E 444, E 445, E 481-482, E 952 dhe E 1105 zëvendësohet me sa vijon:

Grupi III	Ngjyresit me limitin maksimal të kombinuar	200	(87)	Vetëm pije alkoolike me forcë alkoolike për volum me më pak se 15%”
E 104	E verdhë kinoline	180	(61)	Vetëm pije alkoolike me forcë alkoolike për volum më pak se 15%”
E 110	E verdhë e perëndimit të diellit FCF/e verdhë portokalli S	100	(61)	“Vetëm pije alkoolike me forcë alkoolike për volum më pak se 15%”
E 123	Amarant	30		Vetëm pije alkoolike me forcë alkoolike për volum më pak se 15%”
E 124	Ponceau 4R, E kuqe Cokineal A	170	(61)	Vetëm pije alkoolike me forcë alkoolike për volum më pak se 15%”
E 160b(ii)	Annato norbiksinë	10		Vetëm pije alkoolike me forcë alkoolike për volum më pak se 15%”



E 200-202	Acid sorbik – sorbat kaliumi.	200	(1) (2)	Vetëm pije alkoolike me forcë alkoolike për volum më pak se 15%”
E 210-213	Acid benzoik – benzoate	200	(1) (2)	Vetëm pije alkoolike me forcë alkoolike për volum më pak se 15%”
E 220-228	Dioksid squfuri – sulfite.	200	(3)	Vetëm për pije vere - frutash, pije vere - mjaltë, pije vere – frutash të aromatizuara, pije mjaltë - verë të aromatizuar
E 220-228	Dioksid squfuri – sulfite	20	(3)	Vetëm për pije të fermentuara të bazuara në lëng rrushi të fermentuar
E 242	Dikarbonat dimetili	250	(24)	
E 405	Alginat propan-1,2-diol	100		Vetëm për pije të fermentuara të bazuara në lëng rrushi të fermentuar
E 432-436	Polisorbat	10	(1)	vetëm pijet e gazuara
E 444	Ester i acetatit të saharozës me izobutirat	300		vetëm pijet alkoolike të turbullta të aromatizuara dhe përqindje alkooli nën 15%.
E 445	Esterë gliceroli të rrëshirave të drurit	100		vetëm pijet alkoolike të turbullta të aromatizuara dhe përqindje alkooli nën 15%.
E 481-482	stearoil-2-laktilat	8 000	(1)	vetëm pije të aromatizuara me forcë alkoolike në volum më pak se 15 %
E 952	Acid ciklamik dhe kriprat e tij të Na dhe Ca	250	(51)	vetëm përzierje pijesh alkoolike me pije joalkoolike
E 1105	Lizozime	<i>Sasi e mjaftueshme</i>		Vetëm për pije vere - frutash, pije vere - mjaltë, pije vere – frutash të aromatizuara, pije mjaltë - verë të aromatizuar

- Hyrja për E 353 fshihet.

PJESA C ndryshohet si më poshtë:

- në pikën 1 (grupi I), hyrja për aditivët ushqimorë E 334 Acidi tartarik (L(+)-), E 335 Tartratet e natriumit, E 336 Tartratet e kaliumit, E 337 Tartrati i natrium-kaliumit dhe E 354 Tartrati i kalciumit fshihet;

- në pikën 5 (“Aditivë të tjerë që mund të rregullohen përmes kombinimit”), shtohet pika e mëposhtme:

“(k.2) E 334 – 337 dhe E 354: Acidi tartarik – tartrate

Numri E	Emërtimi
E 334	Acid tartarik (L(+)-)
E 335	Tartrate natriumi
E 336	Tartrate kaliumi
E 337	Tartrate natrium-kaliumi
E 354	Tartrate kalciumi

PJESA E ndryshohet si më poshtë:

- në kategorinë e ushqimit 01.3 (“Produkte me bazë qumështi të fermentuar, pa aromatizues, të trajtuara termikisht pas fermentimit”) hyrja e mëposhtme shtohet pas hyrjes për E 200-202:

E 334–337 dhe E 354	Acid tartarik – tartratet	750	(1) (2)	
---------------------	---------------------------	-----	---------	--

- në kategorinë e ushqimit 01.8 (“Analoge të bulmetit, përfshirë pijet e rrahura”), hyrja e mëposhtme shtohet pas hyrjes për E 280–283:

E 334–337 dhe E 354	Acid tartarik – tartratet	240	(1) (2)	
---------------------	---------------------------	-----	---------	--

- në kategorinë e ushqimit 02.2.2 (“Emulsione të tjera yndyrnash dhe vaji, përfshirë yndyrnat e përhapshme dhe emulsione të lëngshme”), hyrja e mëposhtme shtohet pas hyrjes për E 321:

E 334–337 dhe E 354	Acid tartarik – tartratet	1300	(1) (2)	
---------------------	---------------------------	------	---------	--

Në kategorinë e ushqimit 04.2.3 (“Fruta dhe perime të konservuara ose të ambalazuara”), ndryshohet si vijon:

- hyrja për E 334 Acidi tartarik (L(+)-) zëvendësohet si më poshtë:

E 334	Acid Tartarik (L(+)-)	<i>Sasi e mjaftueshme</i>	9000	(98) ’	
-------	-----------------------	---------------------------	------	--------	--

- hyrja për E 335 Tartrate natriumi zëvendësohet si më poshtë:

E 335	Tartrate natriumi	<i>Sasi e mjaftueshme</i>	9000	(51) (98) ’	
-------	-------------------	---------------------------	------	-------------	--

- hyrja për E 336 Tartrate kaliumi zëvendësohet si më poshtë:



E 336	Tartrate kaliumi	Sasi e mjaftueshme	9000	(51) (98)'	
-------	------------------	--------------------	------	------------	--

- hyrja për E 337 Tartrat natrium-kaliumi zëvendësohet si më poshtë:

E 337	Tartrat natrium-kaliumi	Sasi e mjaftueshme	9000	(51) (98)'	
-------	-------------------------	--------------------	------	------------	--

- Shtohet shënimi (98) pas shënimit (56):

‘(98): Maksimumi individualisht ose për kombinimin e E 334–337’;

Në kategorinë e ushqimit 04.2.4.1 (“Përgatitje frutash dhe perimesh, duke përfshirë komposton”), hyrja e mëposhtme shtohet pas hyrjes për E 220-228:

E 334 – 337 dhe E 354	Acid tartarik – tartratet	3000	(1) (2)'	
-----------------------	---------------------------	------	----------	--

Në kategorinë e ushqimit 04.2.5.1 (“Reçel i shtuar dhe xhelatinë e shtuar, siç përcaktohen në urdhrin nr. 417 datë 26.9.2008, “Për miratimin e rregullores “Për reçelin e frutave, xhelet, marmelatat dhe purenë e gështenjave për konsum njerëzor”), hyrja për aditivët ushqimorë E 334 Acidi tartarik (L(+)-) dhe E 335 Tartratet e natriumit fshihet;

Në kategorinë e ushqimit 04.2.5.2 (“Reçel frutash, xhelatina, marmelata dhe pure gështenje e ëmbëlsuar, siç përcaktohen nga në urdhrin nr. 417, datë 26.9.2008, “Për miratimin e rregullores “Për reçelin e frutave, xhelet, marmelatat dhe purenë e gështenjave për konsum njerëzor”) hyrja për aditivët ushqimorë E 334 Acidi tartarik (L(+)-) dhe E 335 Tartratet e natriumit fshihet;

Në kategorinë e ushqimit 04.2.5.3 (“Fruta ose perime të tjera të ngjashme të përhapshme”), hyrja për aditivët ushqimorë E 334 Acidi tartarik (L(+)-) dhe E 335 Tartratet e natriumit fshihet;

Në kategorinë e ushqimit 04.2.6 (“Produkte patateje të përpunuara”), hyrja e mëposhtme shtohet pas hyrjes për E 310-320:

E 334 – 337 dhe E 354	Acid tartarik – tartratet	240	(1) (2)'	
-----------------------	---------------------------	-----	----------	--

Në kategorinë e ushqimit 05.2 (“Ëmbëlsira të tjera, përfshirë mikroëmbëlsira freskuese të frymëmarrjes”), hyrja e mëposhtme shtohet pas hyrjes për E 297:

E 334–337 dhe E 354	Acid tartarik – tartratet	25000	(1) (2)'	
---------------------	---------------------------	-------	----------	--

Në kategorinë e ushqimit 05.3 (“Çamçakëz”), hyrja e mëposhtme shtohet pas hyrjes për E 310-321:

E 334–337 dhe E 354	Acid tartarik – tartratet	25000	(1) (2)'	
---------------------	---------------------------	-------	----------	--

Në kategorinë e ushqimit 05.4 (“Dekorime, veshje dhe mbushje, përveç mbushjeve me bazë frutash të mbuluara nga kategoria 4.2.4”), hyrja e mëposhtme shtohet pas hyrjes për E 297:

E 334–337 dhe E 354	Acid tartarik – tartratet	11000	(1) (2)'	
---------------------	---------------------------	-------	----------	--

Në kategorinë e ushqimit 06.4.1 (“Makarona të freskëta”), hyrja për aditivin ushqimor E 334 Acidi tartarik (L(+)-) fshihet;

Në kategorinë e ushqimit 06.4.3 (“Makarona të freskëta të gatuar paraprakisht”), hyrja për aditivin ushqimor E 334 Acidi tartarik (L(+)-) fshihet;

Në kategorinë e ushqimit 06.4.4 (“Njoki me patate”), hyrja për aditivin ushqimor E 334 Acidi tartarik (L(+)-) fshihet;

Në kategorinë e ushqimit 06.7 (“Drithëra të përpunuara ose të paragatuara”), hyrja e mëposhtme shtohet pas hyrjes për E 310-320:

E 334–337 dhe E 354	Acid tartarik – tartratet	740	(1) (2)'	
---------------------	---------------------------	-----	----------	--

Në kategorinë e ushqimit 07.1 (“Bukë dhe franxholla”), hyrja e mëposhtme shtohet pas hyrjes për E 280-283:

E 334–337 dhe E 354	Acid tartarik – tartratet	15000	(1) (2)	Përveç produkteve në 7.1.1 dhe 7.1.2
---------------------	---------------------------	-------	---------	--------------------------------------

Në kategorinë e ushqimit 07.2 (“Produkte të tjera brumi (të imta furre)”), hyrja e mëposhtme shtohet pas hyrjes për E 310-320:

E 334–337 dhe E 354	Acid tartarik – tartratet	18000	(1) (2)'	
---------------------	---------------------------	-------	----------	--

Në kategorinë e ushqimit 08.3.2 (“Produkte mishi të trajtuara termikisht (me nxehtësi)”), hyrja e mëposhtme shtohet pas hyrjes për E 310-320:

E 334–337 dhe E 354	Acid tartarik – tartratet	3000	(1) (2)	Përveç foie gras, foie gras entier, blocs de foie gras, Libamáj, libamáj egészséges, libamáj tömbben;
---------------------	---------------------------	------	---------	---



Në kategorinë e ushqimit 09.2 (“Peshk dhe produkte peshkimi të përpunuara, përfshirë molusqet dhe krustacet”), hyrja e mëposhtme shtohet pas hyrjes për E 316:

E 334–337 dhe E 354	Acid tartarik – tartratet	2300	(2)';	
---------------------	---------------------------	------	-------	--

Në kategorinë e ushqimit 11.4.2 (“Ëmbëlsues tavoline në formë pluhuri”), hyrja për aditivin ushqimor E 336 Tartrate kaliumi fshihet;

Në kategorinë e ushqimit 11.4.3 (“Ëmbëlsues tavoline në formë tabletash”), ndryshohet si më poshtë:

- hyrja për E 334 Acidi tartarik (L(+)-) zëvendësohet me sa vijon:

E 334	Acid Tartarik (L(+)-)	Sasi e mjaftueshme	270000	(99)';
-------	-----------------------	--------------------	--------	--------

- hyrja për E 336 Tartratet e kaliumit zëvendësohet me sa vijon:

E 336	Tartrate kaliumi	Sasi e mjaftueshme	270000	(51) (99)';
-------	------------------	--------------------	--------	-------------

- Shtohen shënimi (51) përpara shënimit (60) dhe shënimi (99) pas shënimit (60):

‘(51): Nivelet maksimale të lejueshme janë shprehur në acid të lirë’;

‘(99): Sasia maksimale, individualisht ose në kombinim të E 334 dhe E 336’;

Në kategorinë e ushqimit 12.2.2 (“Substanca erëzuese dhe shijuese”), hyrja e mëposhtme shtohet pas hyrjes për E 310-321:

E 334 – 337 dhe E 354	Acid tartarik – tartratet	17000	(1) (2)'	
-----------------------	---------------------------	-------	----------	--

Në kategorinë e ushqimit 12.4 (“Mustardë”), hyrja e mëposhtme shtohet pas hyrjes për E 220-228:

E 334 – 337 dhe E 354	Acid tartarik – tartratet	12000	(1) (2)'	
-----------------------	---------------------------	-------	----------	--

Në kategorinë e ushqimit 12.5 (“Supë dhe lëng mishi ose perimesh”), hyrja e mëposhtme shtohet pas hyrjes për E 310-320:

E 334 – 337 dhe E 354	Acid tartarik – tartratet	240	(1) (2)'	
-----------------------	---------------------------	-----	----------	--

Në kategorinë e ushqimit 12.6 (“Salca”), hyrja e mëposhtme shtohet pas hyrjes për E 310-320:

E 334 – 337 dhe E 354	Acid tartarik – tartratet	4000	(1) (2)'	
-----------------------	---------------------------	------	----------	--

Në kategorinë e ushqimit 12.7 (“Sallatat dhe produktet për lyerje për sanduiche me bazë të kripur”), hyrja e mëposhtme shtohet pas hyrjes për E 200-213:

E 334 – 337 dhe E 354	Acid tartarik – tartratet	1800	(1) (2)'	
-----------------------	---------------------------	------	----------	--

Në kategorinë e ushqimit 12.9 (“Produkte proteinike, përjashtuar produktet e mbuluara nga kategoria 1.8”), hyrja e mëposhtme shtohet pas hyrjes për E 220-228:

E 334 – 337 dhe E 354	Acid tartarik – tartratet	240	(1) (2)'	
-----------------------	---------------------------	-----	----------	--

Në kategorinë e ushqimit 13.1.3 (“Ushqime të përpunuara me bazë drithërash dhe ushqime për foshnja dhe fëmijë të vegjël siç përcaktohet në udhëzimin nr. 20, datë 22.11.2021, “Mbi ushqimin për foshnjat dhe fëmijët e vegjël, ushqimin për qëllime të veçanta mjekësore dhe zëvendësuesit e dietës totale për kontrollin e peshës”) ndryshohet si më poshtë:

- hyrja për E 334 Acidi tartarik (L(+)-) zëvendësohet me sa vijon:

E 334	Acidi tartarik (L(+)-)	5000	(100)	vetëm forma L(+); vetëm biskota, bukë të thatë dhe ushqime për foshnja’;
-------	------------------------	------	-------	--

- hyrja për E 335 Tartratet e natriumit zëvendësohet me sa vijon:

E 335	Tartratet e natriumit	5000	(51) (100)	vetëm forma L(+); vetëm biskota, bukë të thatë dhe ushqime për foshnja’;
-------	-----------------------	------	------------	--

- hyrja për E 336 Tartratet e kaliumit zëvendësohet me sa vijon:

E 336	Tartratet e kaliumit	5000	(51) (100)	vetëm forma L(+); vetëm biskota, bukë të thatë dhe ushqime për foshnja’;
-------	----------------------	------	------------	--

- shënimet (51) dhe (100) shtohen pas shënimit (42):

‘(51): Nivelet maksimale të përdorshme shprehen në acid të lirë

(100) Maksimumi individualisht ose për kombinimin e E 334, E 335 dhe E 336’;

- Hyrja për E 354 Tartrati i kalciumit fshihet.

Në kategorinë e ushqimit 14.1.2 (“Lëngje frutash siç përcaktohen në urdhrin nr. 444 datë 7.12.2007, “Për miratimin e rregullores ‘Për lëngjet e frutave dhe produkteve të ngjashme me to’” dhe lëngjet e perimeve), hyrja për aditivin ushqimor E 336 Tartratet e kaliumit fshihet;



Në kategorinë e ushqimit 14.1.4 ('Pije të aromatizuara'), hyrja e mëposhtme shtohet pas hyrjes për E 297:

E 334 – 337 dhe E 354	Acid tartarik – tartratet	4000	(1) (2)'	
-----------------------	---------------------------	------	----------	--

Në kategorinë e ushqimit 14.2.6, pije alkoolike bëhen ndryshimet si më poshtë:

- hyrja e mëposhtme shtohet pas shënimit për E 220-228:

E 334 – 337 dhe E 354	Acid tartarik – tartratet	1000	(1) (2)'	
-----------------------	---------------------------	------	----------	--

- Shtohet shënimi (2) pas shënimit (1):

'(2): Niveli maksimal zbatohet për shumën dhe nivelet shprehen si acid i lirë';

Në kategorinë e ushqimit 14.2.7.1 ('Vera të aromatizuara'), hyrja e mëposhtme shtohet pas hyrjes për E 242:

E 334 – 337 dhe E 354	Acid tartarik – tartratet	8000	(1) (2)'	
-----------------------	---------------------------	------	----------	--

Në kategorinë e ushqimit 14.2.7.2 ('Pije me bazë verë të aromatizuar'), hyrja e mëposhtme shtohet pas hyrjes për E 242:

E 334 – 337 dhe E 354	Acid tartarik – tartratet	8000	(1) (2)'	
-----------------------	---------------------------	------	----------	--

Në kategorinë e ushqimit 14.2.7.3 ('Kokteje me verë të aromatizuara'), hyrja e mëposhtme shtohet pas hyrjes për E 242:

E 334 – 337 dhe E 354	Acid tartarik – tartratet	8000	(1) (2)'	
-----------------------	---------------------------	------	----------	--

Në kategorinë e ushqimit 14.2.8 ('Pije të tjera alkoolike duke përfshirë përzierjet e pijeve alkoolike me pije joalkoolike dhe pije të tjera alkoolike me më pak se 15 % alkool), hyrja e mëposhtme shtohet pas hyrjes për E 242:

E 334 – 337 dhe E 354	Acid tartarik – tartratet	8000	(1) (2)'	
-----------------------	---------------------------	------	----------	--

Në kategorinë e ushqimit 15.1 ('Snacks (ushqim ndërmjet vakteve) me bazë patate, drithëra, miell ose niseshte'), hyrja e mëposhtme shtohet pas hyrjes për E 310-320:

E 334 – 337 dhe E 354	Acid tartarik – tartratet	60000	(1) (2)'	
-----------------------	---------------------------	-------	----------	--

Në kategorinë e ushqimit 16 ('Ëmbëlsira me përjashtim të produkteve të mbuluara në kategoritë 1, 3 dhe 4'), hyrja e mëposhtme shtohet pas hyrjes për E 297:

E 334 – 337 dhe E 354	Acid tartarik – tartratet	3000	(1) (2)'	
-----------------------	---------------------------	------	----------	--

Në kategorinë e ushqimit 17 ('Suplemente ushqimore siç përcaktohen në urdhrin nr. 216, datë 23.5.2008 "Për miratimin e rregullores "Për ushqimet shitesë"' ndryshuar me urdhrin nr. 565, datë 19.12.2014 "Për një ndryshim në urdhrin nr. 216, datë 23.5.2008, "Për miratimin e rregullores "Për ushqimet shitesë"''), pjesa hyrëse zëvendësohet me sa vijon:

'Nivelet maksimale të përdorimit të treguara për ngjyresit, poliolët, ëmbëlsuesit, E 200-213, E 334-337 dhe E 354, E 338-452, E 405, E 416, E 432-436, E 459, E 468, E 473-475, E 491-495, E 551-553, E 901-904, E 961, E 1201-1204, E 1505 dhe E 1521 i referohen suplementeve ushqimore gati për konsum, të përgatitura sipas udhëzimeve për përdorim të dhëna nga prodhuesi.

Faktori i hollimit për ato suplemente ushqimore që duhet të hollohen ose të shpërbëhen duhet të komunikohet së bashku me udhëzimet për përdorim.

Në kategorinë e ushqimit 17.1 ('Suplemente ushqimore në formë të ngurtë, përjashtuar suplemente ushqimore për foshnja dhe fëmijë të vegjël'), hyrja e mëposhtme shtohet pas hyrjes për E 310-321:

E 334 – 337 dhe E 354	Acid tartarik – tartratet	100000	(1) (2)'	përjashtuar suplementet ushqimore në formë përtypëse
E 334 – 337 dhe E 354	Acid tartarik – tartratet	130000	(1) (2)'	përjashtuar suplementet ushqimore në formë përtypëse

Në kategorinë e ushqimit 17.2 ('Suplemente ushqimore në formë të lëngshme, duke përjashtuar suplemente ushqimore për foshnjat dhe fëmijë të vegjël'), hyrja e mëposhtme shtohet pas hyrjes për E 310-321:

E 334 – 337 dhe E 354	Acid tartarik – tartratet	6000	(1) (2)'	
-----------------------	---------------------------	------	----------	--

Në shtojcën III të udhëzimit nr. 18, datë 9.11.2022, "Për aditivët ushqimorë të lejuar", i ndryshuar, bëhen ndryshimet si më poshtë:



Në pjesën 2, hyrja e mëposhtme shtohet pas hyrjes për E 321:

E 334 – 337 dhe E 354	Acid tartarik – tartratet (Tabela 8 e Pjesës 6)	220 000 mg/kg individualisht ose në kombinim në përgatitje dhe 11 000 mg/kg në produktin final, të shprehur si acid i lirë	E 440 Pektina, të përdorura në kategorinë e ushqimit 05.2 (Ëmbëlsira të tjera, duke përfshirë karamelat freskuese të frymëmarrjes) dhe kategorinë e ushqimit 05.4 (Dekorime, veshje dhe mbushje, përveç mbushjeve me bazë frutash të përfshira në kategorinë 4.2.4);
-----------------------	---	--	--

Në pjesën 3, hyrja për aditivët ushqimorë E 334 Acidi tartarik (L(+)-), E 335 Tartratet e natriumit, E 336 Tartratet e kaliumit, E 337 Tartrati i natrium-kaliumit dhe E 354 Tartrati i kaliumit fshihet;

Në pjesën 4, hyrja e mëposhtme shtohet pas hyrjes për E 320:

E 334 – 337 dhe E 354	Acid tartarik – tartratet (Tabela 8 e pjesës 6)	Të gjithë aromatizuesit	20 000 mg/kg individualisht ose në kombinim në aromatizues dhe 400 mg/kg në produktin final, të shprehur si acid i lirë;
-----------------------	---	-------------------------	--

Në pjesën 5, seksioni A ndryshohet si më poshtë:

- hyrja për aditivët ushqimorë E 334 Acidi tartarik (L(+)-), E 335 Tartratet e natriumit, E 336 Tartratet e kaliumit, E 337 Tartrati i natrium-kaliumit dhe E 354 Tartrati i kaliumit fshihet;

- hyrja e mëposhtme shtohet pas hyrjes për E 333:

E 334 – 337 dhe E 354	Acid tartarik – tartratet (Tabela 8 e pjesës 6)	1000 mg/kg individualisht ose në kombinim në përgatitjen e nutrientëve	Të gjithë lëndët ushqyese;	
-----------------------	---	--	----------------------------	--

Pjesa 6 ndryshohet si më poshtë:

- në tabelën 1, hyrja për aditivët ushqimorë E 334 Acidi tartarik (L(+)-), E 335 Tartratet e natriumit, E 336 Tartratet e kaliumit, E 337 Tartrati i natrium-kaliumit dhe E 354 Tartrati i kaliumit fshihet;

- shtohet tabela e mëposhtme:

Tabela 8. Acidi tartarik – tartrate

Numri E	Emërtimi
E 334	Acid tartarik (L(+)-)
E 335	Tartrate natriumi
E 336	Tartrate kaliumi
E 337	Tartrate natrium-kaliumi
E 354	Tartrate kaliumi

Në pjesën E të shtojcës II të udhëzimit nr. 18, datë 9.11.2022, “Për aditivët ushqimorë të lejuar”, i ndryshuar, në kategorinë e ushqimit 16 “Ëmbëlsirat me përjashtim të produkteve të mbuluara në kategoritë 1, 3 dhe 4”, hyrja për përdorimin e acidit sorbik – sorbat kaliumi (E 200-202) në frugtgrød, rote Grütze në 1 000 mg/kg zëvendësohet si më poshtë:

E 200-202	Acid sorbik - sorbat (kaliumi)	1 000		vetëm frugtgrød, rote Grütze dhe pasha; ëmbëlsira xhelatine me aromë frutash me bazë uji
-----------	--------------------------------	-------	--	--

Në pjesën E të shtojcës II të udhëzimit nr. 18, datë 9.11.2022, “Për aditivët ushqimorë të lejuar”, kategoria e ushqimit 01.7.6 “Produktet e djathit (me përjashtim të produkteve që klasifikohen në kategorinë 16)” është ndryshuar si më poshtë:

- hyrja për celulozën pluhur (E 460) zëvendësohet me sa vijon:

	E 460 (ii)	Celulozë pluhur	Sasi e mjaftueshme	vetëm produkte të pjekura dhe të papjekura të grira dhe të prera në feta; produkte djathi të papjekura të buta që përhapen
--	------------	-----------------	--------------------	--

- hyrja për glukono-delta-lakton (E 575) zëvendësohet me sa vijon:

	E 575	Glukono-delta-lakton	Sasi e mjaftueshme	vetëm produkte të pjekura; produkte djathi të papjekura të buta që përhapen
--	-------	----------------------	--------------------	---



URDHËR
Nr. 683, datë 15.7.2025

PËR DELEGIM TË PËRKOHSHËM
KOMPETENCASH

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të neneve 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; të pikave 2 dhe 3, të nenit 11, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”,

URDHËROJ:

1. Delegimin e përkohshëm të kompetencave të titullarit të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, zëvendësministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, z. Arian Jaupllari, nga data 17.7.2025 deri më datë 20.7.2025.

2. Zëvendësministri ndalohej të nëndelegojë te një organ i tretë kompetencat e përfituara përmes këtij akti delegimi.

3. Për ndjekjen e këtij urdhri ngarkohet zëvendësministri, z. Arian Jaupllari.

4. Me njohjen dhe zbatimin e këtij urdhri ngarkohen të gjithë nëpunësit/punonjësit e Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

5. Ky urdhër hartohet në 3 (tri) kopje të njëjta, 1 (një) për arkiv-protokollin, 1 (një) për Qendrën e Botimeve Zyrtare dhe 1 (një) për zëvendësministrin sipas pikës 1.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL
Anila Denaj

GJYKATA EVROPIANE E TË DREJTAVE
TË NJERIUT
SEKSIONI I TRETË

VENDM
Kërkesa nr. 57935/18
Artan BROCI
kundër Shqipërisë

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Seksioni i Tretë), e mbledhur më 20 maj 2025 si një Komitet i përbërë nga:

Úna Ní Raifeartaigh, *kryetar*,

Darian Pavli,

Mateja Đurović, *gjyqtarë*

dhe Olga Chernishova, *zëvendëssekretare e Seksionit*,

Duke mbajtur në konsideratë:

kërkesën (nr. 57935/18) kundër Republikës së Shqipërisë të depozituar në Gjykatë në mbështetje të nenit 34 të Konventës për Mbrotjtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (“Konventa”) më 10 dhjetor 2018 nga një shtetas shqiptar, z. Artan Broci (“kërkuesi”), lindur në vitin 1973 dhe me banim në Tiranë. Ai u përfaqësua në Gjykatë nga S. Z. A. Saccucci dhe znj. G. Borgna, avokatë që e ushtrojnë ligjin në Romë;

vendimin për të njoftuar mbi ankesat Qeverinë shqiptare (“Qeveria”), përfaqësuar nga Z. O. Moçka, avokat i përgjithshëm i shtetit. Këto kërkesa kishin të bënin me të drejtat e kërkuesit për t’u dëgjuar nga një gjykatë e paanshme dhe për respektimin e jetës private;

vërejtjet e palëve;

vendimin për të rrëzuar kërkesën e ankuesit për përjashtimin e Darian Pavlit, avokat i zgjedhur për Shqipërinë, në gusht 2021 (ish-Rregulli 28 § 2 (d) i Rregullores së Gjykatës);

Pasi diskutoi, vendos si më poshtë:

LËNDA E ÇËSHTJES

1. Çështja ka të bëjë me shkarkimin e kërkuesit nga detyra nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (KPK) dhe Kolegji i Posaçëm i Apelimit (KPA) (shih *Xhoxhaj kundër Shqipërisë*, nr. 15227/19, 9 shkurt 2021).

2. Kërkuesi ka shërbyer si gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Tiranë prej vitit 1996 deri në vitin 2010, dhe në vijim si gjyqtar i gjykatës së apelit dhe i Gjykatës së Lartë. Ai ka shërbyer edhe si anëtar i Këshillit të Lartë të Drejtësisë (KLD) nga viti 2013 deri në vitin 2017.



3. Gjatë një mbledhje të KLD-së në maj 2014, midis kërkesit dhe S. Ç. – një anëtar tjetër i KLD-së – pati një konfrontim. S. Ç. kritikoi mënyrën se si KLD-ja trajtonte transferimet gjyqësore, proceset disiplinore, emërimet në gjykata, dhe menaxhimin e përgjithshëm, duke argumentuar se masat e KLD-së kishin shkaktuar mungesë efikasiteti dhe dështime në sistemin gjyqësor. Kërkesi u përgjigj duke e mbrojtur punën e KLD-së, duke nënvizuar numrin e madh të mbledhjeve dhe përpjekjet për të vlerësuar gjyqtarët, dhe në të njëjtën kohë kritikoi S. Ç. për rolin e tij në KLD, duke pretenduar se kishte mospërputhje në deklaratimet dhe veprimet e tij. Debatu solli ndërhyrjen e kryetarit të mbledhjes, i cili kërkoj që të ruhej rendi dhe të fokusoheshin në agjendë.

4. Më 31 korrik 2018, KPK-ja shkarkoi kërkesin nga detyra, me shumicë votash. Pas apelimit të tij në KPA, çështja iu caktua një paneli me pesë gjyqtarë të përbërë nga I. R. (kryetare), A. H. (relator), L. D., S. Ç. dhe A. S. Kërkesi kundërshtoi S. Ç., i cili më herët kishte qenë gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Tiranë, zëvendëskryetar dhe kryetar i saj, dhe kishte qenë anëtar i KLD-së në vitet 2000, nga viti 2014 deri në vitin 2017. Ai deklaroi se më herët ata kishin pasur debate të ashpra dhe opinione të ndryshme për mënyrën se si S. Ç. kishte votuar për kundërshtarin e kërkesit në një konkurs për pozicionin e kryetarit të asaj gjykate në tetor 2006. Kërkesi bashkëngjiti procesverbalet e mbledhjeve të KLD-së në shkurt dhe maj 2014, nëntor 2015 dhe mars 2016, dhe të një seance dëgjimore të vitit 2006.

5. Një panel i përbërë nga A. H., A. S., N. M., L. D. dhe R. S. e rrëzuan me shumicë votash kërkesën për përjashtim si në vijim:

a) Kërkesi nuk paraqiti prova për të provuar anshmërinë subjektive të S. Ç. Sipas dokumentit të vitit 2006 dhe procesverbalit të katër mbledhjeve të KLD-së në periudhën 2014–16, nuk vërtetohet pretendimi për debate të forta, ku pretendohet se S. Ç. ka mbajtur qëndrime politike në KLD. Këto akte nuk provonin se natyra e marrëdhënies së tyre ishte e tillë që të provonte mungesën e paanshmërisë së S. Ç. në procesin e *vetting*-ut. Në lidhje me debatet e tyre në gjykatën e rrethit ose zgjedhjen e supozuar të S. Ç. për të mosmbështetur kandidaturën e kërkesit në vitin 2006, ato nuk krijojnë një arsyetim legjitim për të pasur frikën se S. Ç. nuk ishte i paanshëm. Ngjarjet kishin ndodhur më shumë se 12 vite më parë, gjë që është një konsideratë e rëndësishme

sipas standardeve ndërkombëtare për etikën gjyqësore dhe paanshmërinë.

b) Diskutimet ose vendimmarrja brenda një organi kolegial si KLD-ja, ose çdo organi tjetër vendimmarrës në sistemin e drejtësisë, mbaheshin sipas ushtrimit të një funksioni publik, duke përfaqësuar Shtetin dhe interesin publik. Vendimet e marra gjatë përmbushjes së detyrave kushtetuese dhe ligjore nuk mund të krijojnë një marrëdhënie personale me personat për të cilët këto vendime pasjellin efekte juridike (jo) të drejtpërdrejta.

6. Më 18 korrik 2019, KPA-ja, në mënyrë unanime, la në fuqi shkarkimin e kërkesit nga detyra për shkak se ai nuk përmbushi detyrimet për vlerësimin e pasurisë (neni 61(3) i ligjit për *vetting*-u, LV), veçanërisht:

a) Në vitin 2006, ai bëri një kontratë porosi për një shtëpi plazhi në Durrës nga Kompania L për 55,140 euro, kishte paguar kështu e parë prej 20,000 eurosh dhe më pas kishte përfituar një ulje prej 5,140 eurosh, kur kishte paguar pjesën tjetër në vitin 2007 (ai kishte lidhje shoqërore me një nga partnerët e kompanisë). Megjithatë, në deklaratimet për *vetting*-un, kërkesi kishte deklaruar si çmim përfundimtar 55,000 euro, duke mosparaqitur çmimin e vërtetë. Ai kishte cituar kursimet midis burimeve të financimit, megjithatë analiza financiare e KPA konstatoi se, edhe nëse të gjitha burimet e të ardhurave të deklaruara për vitin 2006 do të konsideroheshin të ligjshme dhe të provuara, ai përsëri do të kishte një gjendje negative financiare (që do të thotë shpenzime të pajustificuara) për atë vit.

b) Kërkesi deklaroi se ai kishte investuar 82,000 euro në bono thesari në maj 2010 dhe se ajo shumë kishte ardhur nga shuma prej 102,000 eurosh që ai kishte marrë në para në dorë në prill 2010 nga shitja e shtëpisë së plazhit në Durrës për F.G. Megjithatë, kërkesi nuk mundi të provonte se ai i kishte marrë në fakt 102.000 euro, dhe në këtë mënyrë burimi i atij investimi nuk mund të përcaktohet në mënyrë të besueshme. Veçanërisht, në prill 2010, kompania L kishte lidhur kontratë për të njëjtën banesë me F. G., që kishte paguar 82,000 euro për Kompaninë L në prill 2010 dhe 20,000 euro në dhjetor 2010. Kontrata përfundimtare e shitjes për banesën ishte nënshkruar në vitin 2016, përsëri midis F. G. dhe kompanisë. Ekzistenca e dy kontratave për të njëjtën pronë, vlera e së cilës (çmimi i rishitjes) ishte dyfishuar në katër vite (pavarësisht lidhjeve



shoqërore të kërkuessit me F. G.) ngriti pikëpyetje. Kërkuessi nuk paraqiti shpjegime bindëse për këto transaksione.

c) KPA-ja iu referua deklarimeve jokonsistente të kërkuessit në lidhje me pagesën prej 45,000 dollarësh amerikanë për një zyrë në Tiranë në shkurt 2003, pjesërisht, me anë të një huaje bankare prej 24,000 dollarësh amerikanë të marrë në muajin qershor 2003. Ai e kishte deklaruar huan në deklaratën e *vetting*-ut në vitin 2017 si burim për të përfutur një zyrë. Si përgjigje ndaj pyetjeve të KPK-së gjatë hetimit në shkurt 2018, ai pretendoi fillimisht se e kishte përdorur huan bankare për të shlyer paratë që i kishte marrë një të afërmi. Megjithatë, një gjë e tillë as nuk ishte deklaruar dhe as nuk ishte provuar në deklaratimet për *vetting*-un apo në deklaratimin e përvitshëm për vitin 2003. Fondet ishin tërhequr në para në dorë nga banka, pa prova për përdorimin e tyre specifik. Në këtë mënyrë, kërkuessi nuk arriti të provonte origjinën e ligjshme të 24,000 dollarëve amerikanë të paguar në shkurt 2003.

Së fundmi, KPA-ja arriti në përfundimin se kërkuessi nuk kishte mundur të parandalonte një situatë konflikti interesi: (i) në vitin 2014 duke mos u tërhequr nga dëgjimi i një çështjeje me padi prej 391,260 eurosh ndaj Kompanisë L prej së cilës ai kishte blerë pronën në Durrës dhe kishte përfutur uljen prej 5,140 eurosh në vitin 2007; dhe (ii) në dy çështje të tjera. Një gjë e tillë kishte cenuar besimin e publikut në sistemin e drejtësisë (neni 61 (5) i LV).

VLERËSIMI I GJYKATËS

A. Neni 6 i Konventës

1. Parashtrimet e palëve

7. Qeveria argumentoi se ankesa ishte qartazi e pambështetur në fakte. Veçanërisht, debatet midis kërkuessit dhe S. Ç. kishin ndodhur në kuadrin e opinionëve të ndryshme që ata të dy, së bashku me 13 anëtarë të KLD-së, kishin për çështje të paraqitura për shqyrtim nga ai organ kolektiv. Mosmarrëveshje të tjera të pretenduara kishin të bënin me administrimin e gjykatës së rrethit nga S. Ç. në një periudhë edhe më të hershme. S. Ç., një prej pesë gjyqtarëve në panel, as nuk kishte kryesuar dhe as nuk kishte relatuar. Vendimi i trupës gjyquese kishte qenë unanim, kishte vlerësuar të gjitha pikat e apelimit dhe kishte ofruar arsyet e përshtatshme. S. Ç. nuk kishte shprehur asnjë pozicion, dhe as nuk kishte ndërmarrë procedura disiplinore ndaj kërkuessit. Në çështjen e *vetting*-ut, gjyqtari S. Ç. nuk kishte paraqitur vlerësime personale për procesin e

vendimmarrjes në çështjen e kërkuessit, mënjanë vendimit gjyqësor. Konflikti i pretenduar personal midis S. Ç. dhe kërkuessit, brenda gjykatës së rrethit dhe KLD-së (edhe pse i paprovuar) kishte ndodhur në të shkuarën e largët.

8. Kërkuessi pretendoi se gjyqtari i KPA-së, S. Ç., nuk kishte treguar paanshmëri objektive dhe subjektive (shih paragrafët 3 dhe 4 më sipër). Marrëdhënia e tyre armiqësore ishte përqësuar në vitin 2014, pak vite përpara procesit të *vetting*-ut. S. Ç. kishte kritikuar haptazi menaxhimin e përgjegjësisë të KLD-së nga kërkuessi dhe anëtarë të tjerë të këshillit. Në mbledhjen e KLD-së në maj 2014, ai e kishte akuzuar kërkuessin për “gënjeshtër, mashtrim dhe shpifje” kur kërkuessi kishte pretenduar se S. Ç. nuk përmbushte kriteret ligjore për të qenë në KLD. Edhe pse armiqësia e tyre e ndërsjellë kishte filluar gjatë ushtrimit të funksioneve publike, konfrontimet e tyre u përshkallëzuan në sulme personale. Procesverbalet e mbledhjeve të KLD-së konfirmonin se këto ndërveprime konstatonin një armiqësi substanciale midis të dyve. Ato nuk ishin mosmarrëveshje thjesht profesionale, veçanërisht teksa të dy u jepnin zë në mënyrë të vazhdueshme kritikave të forta për njeri-tjetrin. KPA-ja e kishte rrëzuar kërkesën për përjashtim me arsyetim arbitrar, duke mos shuar frikërat e S. Ç. për anshmëri. Vetëm dy ditë përpara se ta rrëzonin kërkesën, KPA-ja kishte rrëzuar S. Ç. në një tjetër çështje ku përfshihej një ish-anëtar i KLD-së.

2. Vlerësimi i Gjykatës

9. Parimet e përgjithshme përkatëse të lidhura me vlerësimin e paanshmërisë përmbledhen në vendimin *Ramos Nunes de Carvalho e Sá kundër Portugalisë* [DHM], nr. 55391/13 dhe 2 të tjerë, §§ 145-47, 6 nëntor 2018, dhe *Rustani 2 Broadcasting Company Ltd dhe të tjerë kundër Gjeorgjisë*, nr. 16812/17, §§ 331-32 dhe 359, 18 korrik 2019.

10. Kërkuessi nuk i ofroi panelit të përjashtimit nga trupa gjyqësore detaje apo prova për natyrën dhe intensitetin e konflikteve të pretenduar me S. Ç. gjatë funksionit të tyre përpara vitit 2006 në një gjykatë rrethi. Fakti se S. Ç. kishte votuar në vitin 2006, brenda një organi vendimmarrës kolegjal, për një kandidat tjetër për pozicionin e kryetarit të gjykatës në vetvete nuk krijonte dyshime legjitime për paanshmërinë e S. Ç. në vitin 2019. Pa elemente shtesë kontekstuale, vetëm ajo votë ishte e pamjaftueshme për të vënë në pikëpyetje paanshmërinë e tij më shumë sesa një dekadë më



vonë. Sipas procesverbaleve të tre seancave të KLD-së, kërkuesi nuk paraqiti ndonjë përmbajtje specifike, dhe Gjykata nuk konstaton ndonjë incident, që do të vërtetonte ose konstatonte kërkesën për tërheqje. Sipas mbledhjes në maj 2014, teksa diskutimi midis kërkuetit dhe S. Ç. me raste kishte pasur kritika që mund të karakterizohen si kritika që hyjnë në jetën personale, Gjykata vlerëson se një rast i tillë në kontekstin e diskutimit kolektiv, në vetvete, nuk mund të merret si provë e një armiqësie personale që do të ndikonte, ose që mendohej se ndikonte në paanshmërinë e një gjyqtari, që duhet të prezumohet deri sa të ketë prova për të kundërtën (shih *Rustavi 2 Broadcasting Company Ltd dhe të tjerë*, cituar më sipër, §§ 331 dhe 361, me referenca të tjera). Nuk rezulton se S. Ç. shprehu gatishmërinë për t'u hakmarrë ose për të kërkuar hakmarrje me anë të rrugëve juridike të disponueshme (*ibid.*, §§ 359 dhe 361), apo se pas kësaj ndërveprimi i tyre, nëse kishte ndonjë të tillë, të ishte problematik.

11. Pasi shqyrtoi provat e vëna në dispozicion dhe parashtimet e palëve, Gjykata nuk konstaton arsye për të mos rënë dakord me vlerësimin e KPA-së në përgjigje të kundërshtimit të kërkuetit për animozitetin personal të S. Ç. gjatë procesit të apelimit në vitin 2019, në lidhje me kërkesën e paanshmërisë subjektive dhe objektive.

12. Kjo ankesë është qartazi e pambështetur në fakte dhe duhet të rrëzohet në përputhje me nenin 35 §§ 3 (a) dhe 4 të Konventës.

B. Neni 8 i Konventës

1. Parashtimet e palëve

13. Qeveria kundërshtoi argumentet e kërkuetit si qartazi të pambështetur në fakte.

14. Kërkuesi pretendoi se shkarkimi i tij nga detyra nuk ishte në përputhje me ligjin, nuk ndiqte ndonjë qëllim legjitim dhe ishte shpërpjesëtimor. Në vërejtjet e tij, ai kundërshtoi gjetjet faktike të KPA-së dhe mungesat financiare të pretenduara. Veçanërisht, KPA-ja u mbështet në një raport financiar që nuk ishte publik për të lënë në fuqi përfundimin e KPK-së se kërkuesi kishte pasur fonde të pamjaftueshme të ligjshme ose të deklaruar për blerjen e bërë në vitin 2006. Kjo e vendoste atë në një disavantazh të padrejtë pa një shpjegim të qartë për mënyrën se si KPA-ja kishte përcaktuar gjendjen financiare negative. Kontrata në vitin 2010 paraqiste kushtet e pagesës, dhe KPA-ja e pranoi se atij nuk i ishte kërkuar ligjërisht që të

përdorte metoda pagesë të gjurmueshme. Megjithatë, sidoqoftë ai u shkarkua pasi nuk provoi të kishte marrë çmimin e rishitjes, sepse vet kontrata nuk provonte një pagesë faktike. Për sa i përket zyrës në Tiranë, KPK-ja nuk kishte transferuar barrën e provës tek ai në lidhje me 24,000 dollarë amerikanë dhe e kishin lënë në terr informacioni për përfundimet e saj përfundimtare për atë shumë; KPA-ja kishte kundërshtuar mandatpagesat dhe deklaratën e betimit të huadhënësit të vitit 2018 si prova jorelevante. Ai nuk kishte deklaruar huan e të afërmit të tij pasi kjo ishte paguar brenda disa muajve, dhe legjislacioni në vitin 2003 kërkonte vetëm bërjen publike të shlyerjeve të huas në proces.

2. Vlerësimi i Gjykatës

15. Shkarkimi i kërkuetit nga detyra ndërhynte me të drejtën e tij për respektimin e jetës së tij private dhe do të shkelte nenin 8 të Konventës, me përjashtim të rastit nëse do të justifikohesh se kjo gjë është në përputhje me ligjin dhe është e nevojshme në një shoqëri demokratike për të përmbushur një qëllim legjitim (shih *Thanza kundër Shqipërisë*, nr. 41047/19, § 135, 4 korrik 2023).

16. Për sa ka të bëjë me vlerësimin e pasurisë, duke përfshirë pronën në Durrës, argumentet e kërkuetit që kundërshtonin ligjshmërinë e ndërhyrjes dhe mungesën e qëllimit legjitim janë të ngjashme me ato që tashmë janë rrëzuar nga Gjykata në një kontekst të ngjashëm (shih *Thanza*, cituar më sipër, §§ 141-47, me referenca të tjera). Mbetet për t'u vlerësuar nëse kjo gjë ishte e nevojshme në një shoqëri demokratike dhe proporcionale për t'i arritur ato qëllime.

17. Së pari, në mbështetje të nenit 6 të Konventës një sërë ankesash u shpallën të papranueshme në periudhën e komunikimit të ankesës. Ato kishin të bënin me mangësi procedurale të lidhura me gjetje faktike dhe përfundime ligjore në lidhje me banesën në Durrës dhe zyrën në Tiranë. Në vërejtjet e tij, kërkuesi ridekloroi të njëjtat pretendime si një aspekt specifik i nenit 8. Gjykata nuk ka konstatuar dobësi serioze në procesin e vendimmarrjes me anë të të cilit u arritën gjetjet faktike të sipërpërmendura në nivel kombëtar, dhe nuk shikon arsye për të miratuar një përfundim tjetër për pranueshmërinë e atyre pretendimeve sipas nenit 8 në këtë fazë të procesit (krahaso *Thanza*, cituar më sipër, §§ 100 dhe 158).

18. Së dyti, në parashtimet e tij në vitin 2020, kërkuesi aludoi në terma të përgjithshëm për “shpërpjesëtimin flagrant” për shkarkimin e tij, por



nuk ngriti argumente specifike në lidhje me justifikimin e KPA-së për shkarkimin e tij nga detyra sipas nenit 61 (3) të LV (shih *Xboxhaj*, cituar më sipër, §§ 412-13, dhe *Nikëbasani kundër Shqipërisë*, nr. 58997/18, §§ 126 dhe 128-129, 13 dhjetor 2022, për argumentet e tjerë, më të përgjithshëm). Ankesat duhet të përmbajnë të gjithë parametrat e nevojshëm në mënyrë që Gjykata të përcaktojë problematikat që do të shqyrtohen dhe nuk duhet të lënë vend për hamendësime në lidhje me qëllimin e elementeve faktike apo argumenteve juridike.

19. Në vijim, kërkuesi pretendoi se gjetjet faktike të KPA-së, interpretimi i legjislacionit vendas dhe përfundimet e tyre – duke përfshirë ato në lidhje me banesën në Durrës dhe zyrën në Tiranë – ishin të pamjaftueshme. Pasi shqyrtoi parashtrimet e palëve, Gjykata nuk konstaton arsye për t'i konsideruar gjetjet dhe përfundimet arbitrare apo qartazi të paarsyeshme. Specifikisht, kërkuesi nuk kishte provuar bindshëm: (i) ekzistencën e fondeve të mjaftueshme të ligjshme për këstin e paguar në vitin 2006 për pronën në Durrës, duke rezultuar në një gjendje financiare negative për atë vit, dhe më e rëndësishmja; (ii) duke pasur në konsideratë kombinimin e faktorëve sipas përcaktimit të KPA-së (shih paragrafin 6 më sipër), realiteti dhe përshtatshmëria e shitjes së supozuar të asaj prone në vitin 2010, dhe origjinën ligjore të 82,000 eurove të investuara në bono thesari menjëherë pas asaj periudhe. Nuk janë konstatuar mangësi në procesin e rregullt në lidhje me këto gjetje (shih paragrafin 17 më sipër). Kërkuesi ka bërë deklaratime jokonsistente në lidhje me 24,000 dollarë amerikanë të paguar në shkurt 2003. Këto arsye ishin relevante dhe të mjaftueshme për të justifikuar shkarkimin e tij nga detyra, duke pasur në konsideratë shumat e mëdha të përfshira, natyrën e parregullsisë të konstatuara nga organet e vetting-ut, dhe pozicionin e kërkuetit si gjyqtar me eksperiencë të gjatë për të përmbushur standardet e larta të ndershmërisë në lidhje me çështjet e tij private financiare (shih *Xboxhaj* cituar më sipër, § 407 *in fine*). Nëse gjykata vendase do të kishin shqyrtuar me kujdes faktet, do të kishin zbatuar standardet përkatëse të të drejtave të njeriut në përputhje me Konventën dhe praktikën e saj ligjore, dhe nëse do të kishin balancuar në mënyrën e duhur interesat individuale përkundrejt interesit publik në një çështje, Gjykata do të kërkonte arsye të forta për të zëvendësuar këndvështrimin e saj në lidhje me vlerësimin e gjykatave (shih *Halet kundër*

Luksemburgut [DHM], nr. 21884/18, §161, 14 shkurt 2023). Për këtë arsye shkarkimi i kërkuetit nga detyra ishte proporcional me qëllimet legjitime në rrethanat e çështjes.

20. Për sa më sipër, nuk është e nevojshme që Gjykata të shqyrtojë nëse shkarkimi i kërkuetit justifikohet edhe në baza të gjetjeve dhe përfundimeve të KPA-së në lidhje me konfliktet e supozuara të interesit dhe sjelljen juridike që cenonte besimin e publikut në sistemin e drejtësisë, sipas nenit 61(5) të LV (krahaso *Xboxhaj*, §§ 410-11, dhe *Thanza*, § 160, të dy cituar më sipër).

21. Në përputhje me rrethanat, ankesa bërë në mbështetje të nenit 8 është qartazi e pambështetur në fakte dhe duhet të rrëzohet në përputhje me nenin 35 §§ 3(a) dhe 4 të Konventës.

Për këto arsye, Gjykata, në mënyrë unanime, *E shpall* kërkesën të papranueshme.

Hartuar në anglisht dhe njoftuar me shkrim më 12 qershor 2025.

Olga Chernishova
Zëvendëssekretare

Úna Ní Raifeartaigh
Kryetar

VENDIM

Nr. 409, datë 16.7.2025

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES “MBI ZHVILLIMIN E PROCEDURAVE PËR RIVLERËSIMIN E SUBJEKTEVE NGA KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR DHE KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË”

Këshilli i Lartë Gjyqësor, në mbështetje të nenit 147, pika 1, nenin 147/a të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve”, ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, mbi propozimin e Grupit Teknik të Punës “Për hartimin e rregullores mbi zhvillimin e procedurave për rivlerësimin e subjekteve nga Këshilli i Lartë Gjyqësor”,

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullores “Mbi zhvillimin e procedurave për rivlerësimin e subjekteve nga



Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe hyn në fuqi në datën e botimit në Fletoren Zyrtare.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR
KRYETAR
Ilir Rusi

RREGULLORE

MBI ZHVILLIMIN E PROCEDURAVE PËR
RIVLERËSIMIN E SUBJEKTEVE NGA
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR DHE
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

Baza ligjore

Kjo rregullore do të interpretohet dhe zbatohet në përputhje me:

1. Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, neni 147 pika 1, nenin 147/a, si edhe neni 149, pika 1 dhe neni 149/a, pika 1, germa “b”.
2. Kodin e Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë.
3. Ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve”.
4. Ligjin nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.
5. Ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve”, i ndryshuar.
6. Aktet e tjera në fuqi që rregullojnë veprimtarinë e Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1 Qëllimi

Qëllimi i kësaj rregulloreje është të përcaktojë rregullat, hapat dhe afatet për zhvillimin e procedurave të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve nga Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe prokurorëve nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vijim, Këshilli ose referuar bashkërisht si këshillat), duke siguruar një proces transparent, të drejtë dhe brenda afateve ligjore të parashikuara në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, ligjin nr. 84/2016 dhe aktet ligjore në fuqi.

Faqe | 19182

Neni 2

Parimet e përgjithshme

Parimet kryesore, mbi bazën e të cilave zhvillon veprimtarinë Komisioni i Përkohshëm dhe Këshilli janë ato të parashikuara në nenin 179/b, pika 2, e Kushtetutës, neni “C”, pika 3, e aneksit dhe neni 4 pika 5 e ligjit nr. 84/2016.

Neni 3

Objekti

Kjo rregullore përcakton rregulla të detajuara mbi:

1. Organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Përkohshëm për procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve.
2. Procedurat për përzgjedhjen e anëtarëve të komisionit dhe kryetarit të Komisionit/relatorit të çështjes, rast pas rasti për secilën çështje.
3. Hapat proceduralë që ndiqen gjatë zhvillimit të procesit të rivlerësimit kalimtar.
4. Detyrat specifike të relatorit të çështjes, i cili është njëkohësisht dhe kryetar i Komisionit dhe anëtarëve të Komisionit.
5. Rolin e ONM-së nëpërmjet vëzhguesve ndërkombëtarë në këtë proces.
6. Veprimet administrative dhe procedurale, duke përfshirë njoftimet dhe trajtimin e dokumentacionit.
7. Afatet kohore për secilin hap të procesit.
8. Kalimin e çështjes në seancë dëgjimore përpara mbledhjes plenare të Këshillit.
9. Procedurat e shqyrtimit, vendimmarrjes dhe ankimit.
10. Monitorimin dhe raportimin e zbatimit të procedurave.

Neni 4

Përkufizime

Për qëllimet e kësaj rregulloreje, termit e mëposhtëm kanë kuptimin si vijon:

1. **“Komisioni i Përkohshëm”** është një komision prej 3 anëtarësh të zgjedhur rast pas rasti me short nga Këshilli, për çdo çështje rivlerësimi në shqyrtim.
2. **“Relatori i çështjes”** i cili është njëkohësisht dhe kryetari i Komisionit, është anëtar i Komisionit të Përkohshëm i zgjedhur përmes shortit, i cili është



përgjegjës për të drejtuar mbledhjet e brendshme të Komisionit, përgatitjen e dosjes, kryerjen e hetimit administrativ, mbledhjen e dokumentacionit dhe përgatitjen e relacionit të çështjes, siç parashikohet në nenin 14, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.

3. “Vëzhguesit ndërkombëtarë” janë personat e caktuar nga Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit dhe të informuar në përputhje me nenin B të aneksit të Kushtetutës.

4. “Short” është procesi i zgjedhjes së anëtarëve dhe relatorit të caktuar mbi çështjen në mënyrë rastësore, i cili është edhe kryetari i Komisionit të Përkohshëm, të organizuar nga Këshilli.

5. “Subjektet e rivlerësimit” janë të gjithë personat e parashikuar në nenin 179/b, pikat 3 dhe 4 të Kushtetutës.

6. “Relacion paraprak” është relacioni i përgatitur nga relatori i çështjes/kryetari i Komisionit dhe i miratuar nga Komisioni i Përkohshëm, që i paraqitet Këshillit për miratim në mbledhje plenare.

Neni 5

Komisioni i Përkohshëm

1. Për zhvillimin e procesit administrativ (hetimit), do të ngrihet për secilën çështje një Komision i Përkohshëm për Rivlerësimin Kalimtar, i cili përbëhet nga 3 anëtarë, **2 anëtarë gjyqtarë/prokurorë dhe 1 anëtar jo gjyqtar/prokuror**, të zgjedhur në mënyrë rastësore, me short nga anëtarët e Këshillit.

2. Relatori i çështjes zgjidhet me short nga mbledhja plenare dhe është njëkohësisht kryetari i Komisionit të Përkohshëm.

3. Procedurat e shortit dokumentohen me procesverbal, ku përfshihen emrat e anëtarëve të përzgjedhur dhe rendi i caktimit të tyre.

4. Raportimi në Këshill për punën e realizuar nga Komisioni i Përkohshëm, realizohet nga Komisioni Disiplinor, sipas pikës 16, të nenit 62, të ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Neni 6

Konflikti i interesit

1. Anëtari i Këshillit, i pranishëm në mbledhjen e Këshillit ose të Komisionit të Përkohshëm, i cili është në dijeni të një konflikti interesi ose të një

pengese ligjore, për veten ose për një anëtar tjetër, lidhur me një çështje të rendit të ditës, është i detyruar për sa vijon:

1) të deklarojë natyrën e interesit ose pengesës;

2) të mos përfshihet në emrat që do të përzgjidhen me short si anëtar të komisionit të përkohshëm;

3) të mos marrë pjesë në diskutimin e çështjes përkatëse;

4) të mos marrë pjesë në votimin e çështjes përkatëse.

2. Çdo anëtar i Këshillit i cili është në dijeni të një konflikti interesi ose të një pengese ligjore për veten ose për një anëtar tjetër, menjëherë pas marrjes dijeni për zhvillimin e mbledhjes me qëllim hedhjen e shortit për përzgjedhjen e Komisionit të Përkohshëm, deklaron konfliktin e interesit ose pengesën ligjore, sipas nenit 31 të Kodit të Procedurave Administrative, neneve 72 dhe 74, të ligjit 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe ligjit nr. 9367, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar.

3. Në rastet e konfliktit të interesit, sipas nenit 75, të ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” apo ligjit nr. 9367, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, anëtari kërkon heqjen dorë nga pjesëmarrja në mbledhje plenare ose mbledhje komisioni. Vendimi për pranimin e dorëheqjes së anëtarit, merret nga kryetari i Këshillit. Vëzhguesit ndërkombëtar duhet t’i jepet mundësia të shprehë mendimin e tij përpara se të merret vendimi.

4. Anëtari për të cilin pretendohet konflikti i interesit ose pengesa ligjore, deklaron qëndrimin e tij në lidhje me këtë pretendim. Nëse anëtari vlerëson se pretendimi qëndron, sipas rastit, ai nuk merr pjesë në diskutimin apo votimin e çështjes përkatëse ose kërkon heqjen dorë. Kur kërkesa për heqje dorë bëhet në mbledhje plenare ose në mbledhje të Komisionit të Përkohshëm, diskutimi ose votimi i çështjes në fjalë mund të shtyhet për në mbledhjen e radhës.

5. Subjekti i rivlerësimit ose përfaqësuesi ligjor i tij, brenda 3 ditëve nga marrja e njoftimit, mund të kërkojë përjashtimin e anëtarit të Këshillit nga pjesëmarrja në shqyrtimin e procedurës administrative, kur ekziston një nga shkaqet e parashikuara nga ligji.



6. Vendimi për përjashtimin e një anëtari, nga shqyrtimi i një çështjeje në Komisionin e Përkohshëm dhe në Këshill, merret nga Këshilli, sipas rregullave të parashikuara në seksionin 3, të ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar. Kur kërkohet përjashtimi i kryetarit të Këshillit, mbledhja plenare kryesohet nga zëvendëskryetari i Këshillit. Vëzhguesi ndërkombëtar ka të drejtë të marrë pjesë në diskutimin e kësaj çështjeje.

Neni 7

Kuorumi dhe mbledhja e Komisionit të Përkohshëm

1. Mbledhjet e Komisionit të Përkohshëm drejtohen nga relatori i çështjes, i cili është njëkohësisht kryetar i Komisionit dhe janë të vlefshme vetëm kur në të marrin pjesë gjithë anëtarët e komisionit si edhe vëzhguesi ndërkombëtar.

2. Komisioni i Përkohshëm mbledhet, në ditën dhe orën e caktuar nga kryetari i Komisionit/relatori i çështjes.

3. Relatori i çështjes cakton rendin e ditës për mbledhjen, pas konsultimit me anëtarët e tjerë të Komisionit të Përkohshëm dhe vëzhguesin ndërkombëtar. Para mbledhjes, çdo anëtar i Komisionit të Përkohshëm ose vëzhguesi ndërkombëtar nëpërmjet kryetarit të Komisionit, mund të kërkojë shtimin e çështjeve të tjera në rendin e ditës. Ato përfshihen nëse votojnë pro kërkesës, jo më pak se 2 anëtarë.

4. Komisioni i Përkohshëm, dhe vëzhguesi ndërkombëtar, nëpërmjet relatorit të çështjes, ka të drejtë të kërkojë çdo dokumentacion i cili konsiderohet i nevojshëm për veprimtarinë e tij sipas ligjit.

5. Anëtari i Komisionit të Përkohshëm dhe vëzhguesi ndërkombëtar ka të drejtë të dëgjohet për mendimin e tij në lidhje me çështjen që diskutohet. Vendimet në komision merren me shumicë votash të të gjithë anëtarëve.

6. Rregullat e zhvillimit të mbledhjes së Komisionit të Përkohshëm janë të njëjta me ato të zhvillimit të mbledhjes plenare të Këshillit, për aq sa ato janë të zbatueshme. Rregullat për pjesëmarrjen dhe vendimmarrjen në distancë në Këshill, zbatohen për aq sa është e mundur edhe për Komisionin e Përkohshëm.

Neni 8

Detyrat dhe përgjegjësitë e relatorit të çështjes dhe anëtarëve të Komisionit të Përkohshëm

1. Relatori i çështjes, njëkohësisht kryetari i Komisionit të Përkohshëm, është përgjegjës për:

a) funksionimin e duhur të Komisionit të Përkohshëm;

b) mbikëqyrjen e punës dhe administrimin e Komisionit të Përkohshëm;

c) përgatitjen e dosjes e cila do të diskutohet nga Komisioni i Përkohshëm;

ç) ndërmarrjen e të gjitha procedurave për sigurimin e provave që konsiderohen të nevojshme për vendimmarrjen e trupit gjykues;

d) ndërmarrjen e të gjithë hapave të nevojshëm për hartimin e dokumentacionit deri në përfundimin e çështjes;

dh) kërkimin e informacionit shtesë, në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 84/2016;

e) mbajtjen e kontakteve me vëzhguesin ndërkombëtar gjatë hetimit, sipas nevojës;

ë) propozimin për marrjen e një vendimi dhe përgatitjen e relacionit të tij;

f) caktimin e rendit të ditës, orës dhe datës së mbledhjes, si dhe kryesimin e mbledhjeve të Komisionit të Përkohshëm;

g) përgatitjen e mbledhjes dhe shpërndarjen e të gjitha materialeve të mbledhjes, në kohën e duhur, për anëtarët e Komisionit të Përkohshëm.

2. Detyrat dhe përgjegjësitë e anëtarëve të Komisionit të Përkohshëm janë:

a) të marrin pjesë, të respektojnë dhe zbatojnë procedurat për mbledhjet e Komisionit të Përkohshëm;

b) të realizojnë brenda afateve kohore detyrat e caktuara nga Komisioni i Përkohshëm;

c) të informojnë sa më herët të jetë e mundur kryetarin e Komisionit/relatorin e çështjes, kur nuk mund të marrin pjesë në mbledhjen e Komisionit të Përkohshëm;

ç) të ruajnë konfidencialitetin dhe mbrojnë informacionin sensitiv që lidhet me mbledhjet me dyer të mbyllura të Komisionit të Përkohshëm;

d) të shmangin favorizimin, anshmërinë ose diskriminimin mbi çfarëdo baze, kur shqyrtojnë çështje, marrin vendime ose votojnë për çështje që i paraqiten Komisionit të Përkohshëm;



dh) të përdorin ekskluzivisht adresën e postës zyrtare të Këshillit për të gjitha komunikimet e brendshme dhe të jashtme që lidhen me punën dhe aktivitetet e Komisionit të Përkohshëm dhe të Këshillit.

Neni 9

Të drejtat e subjektit të rivlerësimit

1. Të drejtën për t'u njoftuar mbi kalimin e barrës së provës sipas paragrafit 5 të nenit Ç, paragrafit 5 të nenit D, paragrafit 4 të nenit DH dhe paragrafit 5 të nenit E të aneksit të Kushtetutës, nëse provat kanë nivelin e provueshmërisë, sipas neneve 45 dhe 52 të ligjit nr. 84/2016.

2. Të drejtën për t'u njohur me dokumentet e dosjes së kësaj procedure, si dhe të marrë një kopje të tyre. Dosja i vihet në dispozicion subjektit sipas neneve 45–47 të Kodit të Procedurave Administrative, duke respektuar të drejtat e palëve sipas neneve 35–40 të Kodit të Procedurave Administrative.

3. Të drejtën për të kërkuar thirrjen e dëshmitarëve apo marrjen e çdo prove mbështetëse. Kjo kërkesë duhet të përmbajë të gjitha informacionet e nevojshme për identifikimin dhe kontaktimin e dëshmitarit, si dhe të dhëna mbi thelbin e informacionit të pritsëm.

4. Afatin brenda të cilit duhet bëjë kërkesën me shkrim për njohjen me dosjen dhe të paraqesë prova/shpjegime me shkrim apo të bëjë kërkesa në përputhje me pikat “d” dhe “e” të kësaj pike. Ky afat nuk mund të jetë më pak se 5 ditë dhe jo më shumë se 7 (shtatë) ditë nga data e njoftimit të subjektit për t'u njohur me dosjen.

Neni 10

Mungesa e anëtarit të Komisionit të Përkohshëm

1. Në rast se një nga anëtarët e Komisionit të Përkohshëm deklaron heqjen dorë nga përbërja në Komision, përjashtohet për shkak të konfliktit të interesit apo ndonjë pengese tjetër ligjore, ose mungon në detyrë për arsye të tjera të pamundësisë objektive, ai zëvendësohet nga një anëtar tjetër i Këshillit, i cili përzgjidhet me short gjatë mbledhjes plenare.

2. Në çdo rast një anëtar gjyqtar i Komisionit të Përkohshëm do të zëvendësohet nga shorti mes

anëtarëve gjyqtarë dhe një anëtar jogjyqtar/joprokuror do të zëvendësohet nga shorti mes anëtarëve jogjyqtarë/joprokurorë.

Neni 11

Njësia Mbështetëse e Komisionit të Përkohshëm

1. Komisioni i Përkohshëm asistohet në punën e tij nga Njësia e Këshilltarëve të Komisioneve të Përhershme, që ushtron veprimtari këshilluese dhe ndihmëse në procesin vendimmarrës.

2. Njësia përbëhet nga të paktën një këshilltar ligjor dhe një ekonomik.

3. Kjo njësi krijohet me këshilltarë ligjorë dhe ekonomikë që ushtrojnë aktualisht detyrën, në Këshill, ose këshilltarë të rekrutuar nga jashtë institucionit për këtë qëllim.

Neni 12

Detyrat e këshilltarit

1. Këshilltari ligjor ka këto detyra:

a) studimi i dosjes dhe përgatitja e relacionit për çështjen;

b) kryerja e detyrave të tjera të caktuara nga kryetari i Komisionit.

2. Këshilltari ekonomik ka këto detyra:

a) studimi i dosjes nga pikëpamja financiare/ekonomike dhe përgatitja e relacionit të çështjes, veçanërisht për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit;

b) kryerja e detyrave të tjera të caktuara nga kryetari i Komisionit.

3. Këshilltari ligjor ose ekonomik përgjegjës, në çdo kohë, kur merr dijeni për ekzistencën e një konflikti interesi ose pengese ligjore në lidhje me një çështje, është i detyruar të deklarojë natyrën e konfliktit të interesit ose pengesës dhe të heqë dorë nga kryerja e detyrave apo veprimtarive të Komisionit të Përkohshëm gjatë shqyrtimit të çështjeve. Kërkesa për dorëheqje i drejtohet kryetarit të Këshillit, i cili kur vendos pranimin, cakton dhe këshilltarin ligjor përgjegjës zëvendësues nga Njësia e Këshilltarëve të Komisioneve të Përhershme ose nga struktura përkatëse, pranë Këshillit.



Neni 13

Personeli administrativ i Këshillit

1. Me fillimin e procedurave sipas kësaj rregulloreje, kryetari i Këshillit me kërkesë të relatorit të çështjes, i cili është njëkohësisht kryetar i Komisionit të Përkohshëm, cakton personelin administrativ përgjegjës për kryerjen e detyrave të përcaktuara në pikën 2 të këtij neni. Në mungesë të kërkesës së relatorit të çështjes për caktimin e personelit administrativ ndihmës, të gjitha detyrat e përcaktuara në pikën 2, të këtij neni, përmbushen nga njësia mbështetëse e Komisionit të Përkohshëm.

2. Personeli administrativ i cili ushtron veprimtari ndihmëse sipas pikës 1 të këtij neni, duke përmbushur pa u kufizuar në to, detyrat vijuese:

a) regjistrimin e të dhënave në regjistrin e posaçëm në lidhje me çështjet e paraqitura për shqyrtim në Këshill;

b) përcjelljen e çështjes te Komisioni Disiplinor për të vijuar sa më shpejt të jetë e mundur, me procedurat për hedhjen e shortit;

c) dorëzimin e dosjes së çështjes te relatori i çështjes, i cili është njëkohësisht kryetar i Komisionit dhe bashkëpunimin me këshilltarin ligjor përgjegjës, për mbarrëvajtjen e të gjithë procedurës;

ç) mbajtjen e procesverbalit të mbledhjeve të Komisionit të Përkohshëm;

d) mbajtjen e të gjitha komunikimeve të vazhdueshme të njoftimeve dhe të akteve shkresore, me subjektet ankuese/kërkuese ose me përfaqësuesit e tyre, gjatë shqyrtimit të çështjes, mbi bazën e udhëzimeve të relatorit të çështjes;

dh) redaktimin e akteve të Komisionit të Përkohshëm;

e) numërtimin e vendimit pas përfundimit të plotë të shqyrtimit të çështjes dhe dhënies së vendimit;

ë) marrjen në dorëzim të dosjes nga relatori i çështjes në përfundim të procedurës dhe depozitimin e saj për arkivim;

f) vënien në dispozicion të strukturave të Këshillit dhe Komisionit të Përkohshëm të çdo lloji informacioni, dokumentacioni dhe statistike, për qëllime të procedurës.

3. Personeli administrativ i caktuar sipas pikës 1 të këtij neni, në çdo kohë, kur merr dijeni për ekzistencën e një konflikti interesi ose pengese ligjore në lidhje me një çështje, është i detyruar të

deklarojë natyrën e konfliktit të interesit ose pengesës dhe të heqë dorë nga pjesëmarrja në veprimtarinë e Komisionit të Përkohshëm gjatë shqyrtimit të kësaj çështjeje. Kërkesa për dorëheqje i drejtohet Sekretarit të Përgjithshëm, i cili kur vendos pranimin, cakton dhe personelin administrativ zëvendësues nga anëtarët e personelit të Këshillit.

Neni 14

Fillimi i procedurës

1. Procedura fillon me:

- administrimin në Këshill të rezultateve të testimit nga Shkolla e Magjistraturës, për subjektet për të cilët KPK-ja ka vendosur pezullim nga detyra për një periudhë 1-vjeçare dhe detyrimin për të ndjekur programin e trajnimit, sipas kurikulave të miratuara nga Shkolla e Magjistraturës;

- administrimin e vendimit të KPA-së, nëpërmjet të cilit është vendosur rishikimi i vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

2. Brenda 7 ditëve nga fillimi i procedurës, hidhet shorti për ngritjen e Komisionit të Përkohshëm dhe relatorit të çështjes, i cili është edhe kryetar i këtij Komisioni.

Neni 15

Veprimtaria administrative

1. Brenda 10 (dhjetë) ditëve nga njoftimi i subjektit të rivlerësimit me përbërjen e Komisionit të Përkohshëm, të drejtën e deklarimit të konfliktit të interesit, si edhe dërgimin e pyetësorit tip, sipas përcaktimeve të kësaj rregulloreje, Komisioni i Përkohshëm zhvillon mbledhjen e parë, në të cilën ndërmerren këta hapa:

a) mund të paraqiten kërkesa për përjashtim për anëtarët e Komisionit të Përkohshëm dhe Këshillit, nëse ka të tilla;

b) vendoset për fillimin e hetimit kryesisht, si dhe vlerësimit të fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit.

2. Relatori i çështjes, i cili është njëkohësisht kryetar i Komisionit të Përkohshëm pasi studion dosjen, ndërmerr të gjithë hapat për të siguruar provat e nevojshme për procesin e vendimarrjes së Këshillit, sipas neneve 45–54 të ligjit nr. 84/2016. Këshilltari juridik dhe këshilltari ekonomik i çështjes japin opinion dhe përgatisin relacionet e tyre në



lidhje me hapat proceduralë të ndërmarrë dhe rezultatet e hetimit.

3. Vëzhguesit ndërkombëtar i garantohet ushtrimi i të drejtave të tij në bazë të nenit “B” të aneksit të Kushtetutës dhe neneve 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, në të gjitha fazat e procesit.

4. Relatori i çështjes i cili është njëkohësisht kryetar i Komisionit të Përkohshëm vendos në dijeni vëzhguesin ndërkombëtar për hapat proceduralë të ndjekur dhe rezultatet e hetimit. Vëzhguesi ndërkombëtar ka të drejtë të njihet në mënyrë të plotë me çdo dokument përbërës të dosjes dhe me të gjitha komunikimet ndërmjet palëve në proces.

5. Në përfundim të hetimit kryesisht dhe vlerësimit të fakteve e rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, relatori i çështjes, i ndihmuar nga këshilltari ligjor dhe këshilltari ekonomik, përgatit relacionin paraprak të hetimit, ua përcjell anëtarëve të Komisionit të Përkohshëm dhe njofton vëzhguesin ndërkombëtar, me qëllim thirrjen e mbledhjes së Komisionit të Përkohshëm, e cila mbahet në prani të vëzhguesit ndërkombëtar. Në këtë mbledhje, Komisioni i Përkohshëm, pasi dëgjon relatorin e çështjes, shqyrton gjetjet dhe/ose mendimin me shkrim të vëzhguesit ndërkombëtar dhe jep opinionin për vazhdimin e hetimit kryesisht ose mbylljen e tij.

6. Në rast të vazhdimin të hetimit kryesisht, relatorit i çështjes merr masa për kryerjen e procedurës së nevojshme.

7. Kur dosja është gati dhe ka përfunduar afati për dorëzimin e provave dhe shpjegimeve me shkrim nga subjekti, relatori i çështjes përgatit relacionin përfundimtar dhe ia vë në dispozicion Komisionit të Përkohshëm, anëtarëve të Këshillit dhe vëzhguesit ndërkombëtar.

8. Kur Komisioni i Përkohshëm vlerëson se janë ndërmarrë të gjithë hapat e nevojshëm hetimorë për përfundimin e hetimit administrativ, nëpërmjet relatorit të çështjes/kryetarit të Komisionit, njofton kryetarin e Këshillit me qëllim thirrjen e mbledhjes plenare të Këshillit.

9. Komisioni i përkohshëm njofton subjektin e rivlerësimit mbi rezultatet e hetimit sipas pikës 7 si edhe mbi të drejtat e tij.

10. Kryetari i Këshillit cakton mbledhjen plenare jo më vonë se 2 javë nga njoftimi për përfundimin e hetimit.

11. Në mbledhjen plenare, Këshilli, në prani të vëzhguesit ndërkombëtar, merr vendim dhe njofton subjektin e rivlerësimit, për sa më poshtë vijon:

a) përfundimin e procedurave të hetimit kryesisht;

b) caktimin e datës së zhvillimit të seancës dëgjimore dhe njoftimin e subjektit, për datën, orën dhe vendin e zhvillimit të saj. Afati për zhvillimin e seancës dëgjimore nuk mund të jetë më shumë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga data e njoftimit të subjektit për t’u dëgjuar në seancë. Subjekti i rivlerësimit duhet të dorëzojë mbrojtjen me shkrim të paktën 1 (një) ditë përpara seancës dëgjimore;

c) brenda 5 (pesë) ditëve nga paraqitja e kërkesës së subjektit për thirrjen e një dëshmitari apo marrjen e një prove, Këshilli, në prani të vëzhguesit ndërkombëtar, vendos me arsyetim për pranimin apo refuzimin e kërkesës. Në rast se kjo kërkesë pranohet, relatori i çështjes ka detyrimin të marrë deklarin/provën mbështetëse, ta vlerësojë atë dhe ta përfshijë në relacionin përfundimtar.

12. Në rast se dosjes së një subjekti të rivlerësimit, i cili e ka ushtruar të drejtën e tij/saj për t’u njohur me dosjen, i shtohen prova apo fakte të reja, që ndikojnë në vendimarrje, për të cilat subjekti nuk ka marrë dijeni, ky subjekt do të njoftohet përsëri për t’u njohur me to, sipas procedurës më sipër.

13. Këshilli, në mbledhjen e thirrur nga relatori i çështjes, i cili është njëkohësisht kryetari i Komisionit, në prani të vëzhguesit ndërkombëtar, mund të vendosë për kthimin e çështjes te Komisioni i Përkohshëm për hetime të mëtejshme ose për kalimin e çështjes në seancë dëgjimore.

14. Vendimarrja e Këshillit i njoftohet subjektit të rivlerësimit i arsyetuar me shkrim.

Neni 16

Seanca dëgjimore

1. Seanca dëgjimore është publike dhe zhvillohet sipas përcaktimeve në nenin 20, të ligjit nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, të ndryshuar. Në seancë dëgjimore do mundësohet përkthim në anglisht për vëzhguesit ndërkombëtarë.

2. Seanca dëgjimore drejtohet nga kryetari i Këshillit, i cili pasi identifikon subjektin e rivlerësimit dhe/ose përfaqësuesin e tij, ia jep fjalën relatorit të çështjes. Relatori i çështjes bën një përmbledhje të



shkurtër të dosjes, si dhe të hapave proceduralë hetimorë të ndërmarrë. Pas relatorit të çështjes, i jepet fjala subjektit të rivlerësimit/përfaqësuesit të tij, për të dhënë shpjegime mbi themelin e çështjes. I bën të njohur subjektit të rivlerësimit që përmbajtja e parashtrimeve me shkrim nuk përsëritet gjatë seancës dëgjimore, sipas nenit 142, pika 4 e ligjit “Për statusin”.

3. Në rast se subjekti pranon t’ju përgjigjet pyetjeve në bazë të pikës 3 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, anëtarët e Këshillit dhe/ose vëzhguesi ndërkombëtar mund t’i drejtojnë pyetje në lidhje me çdo çështje objekt rivlerësimi. Në përfundim të seancës, subjekti i rivlerësimit mund të bëjë një deklaratë përmbyllëse, koha e së cilës përcaktohet nga kryetari i Këshillit.

Neni 17

Vendimi i Këshillit

1. Diskutimet për marrjen e vendimit ndaj subjektit të rivlerësimit zhvillohen nga Këshilli me dyer të mbyllura, në praninë e vëzhguesit ndërkombëtar.

2. Vendimi i Këshillit merret me votim të hapur dhe me shumicë të thjeshtë të anëtarëve të Këshillit dhe shpallet si rregull në fund të seancës dëgjimore nga kryetari i Këshillit.

3. Arsyetimi përgatitet nga relatori i çështjes brenda 30 ditësh, nga data e shpalljes së vendimit, sipas arsyetimit të shumicës së anëtarëve që kanë votuar në favor të tij.

4. Nëse pas votimit të vendimit, relatori i çështjes, i cili është njëkohësisht kryetari i Komisionit është në pakicë, kryetari i Këshillit, cakton një anëtar tjetër nga shumica për të arsyetuar vendimin përfundimtar.

5. Nëse gjatë vendimmarrjes ka qëndrime të ndryshme nga ai i shumicës, anëtari i Këshillit i mbetur në pakicë arsyeton me shkrim mendimin e tij.

6. Procesverbali i bisedimeve të çështjes mbahet nga personeli i regjistrisë të Këshillit.

7. Vëzhguesi ndërkombëtar ka të drejtë të përgatisë një mendim ndryshe/paralel që i bashkohet vendimit.

8. Vendimi me shkrim u njoftohet subjektit të rivlerësimit, drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme dhe vëzhguesit Ndërkombëtar.

9. Vendimi publikohet në faqen zyrtare të institucionit *www.klgj.al*, i shoqëruar me arsyetimin përkatës, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimitit të subjekteve, përveç kur në ligj parashikohet ndryshe, duke respektuar kërkesat e ligjit nr. 9887/2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”.

Neni 18

Mënyrat e njoftimit të akteve

Njoftimi për çdo komunikim gjatë procedurave të përcaktuara në këtë rregullore bëhet në përputhje me format dhe kërkesat e parashikuara në nenin 46, të ligjit nr. 84/2016.

Neni 19

Arkivimi i praktikës dokumentare

Praktika dokumentare arkivohet në Zyrën e Protokoll-Arkivit të Këshillit në përputhje me legjislacionin në fuqi mbi arkivat.

Neni 20

Publiciteti i seancës dëgjimore

1. Mbledhjet e Këshillit dhe të Komisionit të Përkohshëm përveç seancës dëgjimore e cila është publike, zhvillohen të mbyllura.

2. Këshilli, kryesisht ose me kërkesë të palëve, mund të vendosë zhvillimin e seancës dëgjimore me dyer të mbyllura, në rastet:

a) kur publiciteti i seancës dëgjimore mund të dëmtojë moralin e shoqërisë ose mund të bëjë publike të dhëna sekrete në interes të sigurisë kombëtare, nëse kjo kërket nga autoritetet kompetente;

b) kur është e nevojshme të mbrohet e drejta e jetës private, të mbrohen të dhënat personale të magistratit ose një personi tjetër;

c) në rastet kur nga publiku evidentohen sjellje që cenojnë zhvillimin normal të seancës dëgjimore.

3. Kur Këshilli zhvillon mbledhje me dyer të mbyllura, publiku dhe media largohen nga salla e mbledhjeve. Në çdo rast votimi është i hapur.



Neni 21

Solemniteti i seancës

1. Gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore respektohen rregullat e solemnitetit, të cilat janë:

a) respektimi i orarit të caktuar për zhvillimin e seancës nga pjesëmarrësit;

b) respektimi i rendit dhe qetësisë gjatë zhvillimit të seancës;

c) respektimin nga palët të kërkesave për të parashtruar në bazë të fakteve të pretenduara shpjegimet e nevojshme e të dobishme për shqyrtimin e çështjes;

ç) respektimin e anëtarëve të Këshillit dhe të të gjithë pjesëmarrësve të tjerë në gjykim;

d) mbajtjen e veshjes serioze dhe të përshtatshme nga avokatët dhe pjesëmarrësit e tjerë në sallë.

2. Në rast se palët në seancë nuk respektojnë rregullat e solemnitetit, kryetari i Këshillit i këshillon dhe iu tërheq vëmendjen për zhvillimin e duhur të seancës. Nëse rregullat e solemnitetit nuk zbatohen dhe pas ndërhyrjes së kryetarit të Këshillit, ky i fundit ndërpret seancën dhe urdhëron largimin e pjesëmarrësve që kanë cenuar solemnitetin.

3. Prania e shtypit të shkruar dhe elektronik në sallë, gjatë seancës dëgjimore publike, është e lejuar, për sa kohë nuk pengon zhvillimin normal të seancës. Regjistrimi audio, video dhe fotografimi nga mediat e pranishme, gjatë seancës, si rregull, nuk lejohet. Regjistrimi audio, video dhe fotografimi realizohen sipas rregullave të hollësishme të marrëdhënieve me median, të miratuara me rregulloren për Komunikimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor me Median, miratuar me vendimin e KLGJ-së, nr. 592, datë 26.11.2020 dhe rregulloren për Komunikimin e Këshillit të Lartë të Prokurorisë me Median, miratuar me vendimin nr. 268, datë 11.10.2022.

4. Në rastin kur magjistrati ose përfaqësuesi i tij, dëshmitari ose eksperti cenonë mbarëvajtjen e procesit, ose kryejnë ndonjë veprim, që në mënyrë të dukshme ka për qëllim të vonojë procedurën, Këshilli paralajmëron magjistratin dhe e udhëzon mbi pasojat e kësaj sjelljeje.

5. Për sigurimin e solemnitetit dhe garantimin e zhvillimit normal të seancës, kryetari i Këshillit ndihmohet nga personeli administrativ.

Neni 22

Masat për shmangien e vonesave

Në rastet kur ndonjëra nga palët nuk paraqitet në seancë dëgjimore, ndonëse është njoftuar dhe nuk ka pasur shkaqe të ligjshme për t'u paraqitur, Këshilli deklaron mungesën, dhe seanca zhvillohet pa praninë e palës.

DISPOZITAT E FUNDIT

Neni 23

Akte të tjera të zbatueshme

Për çështjet që nuk janë të rregulluara në këtë rregullore, gjejnë zbatim për aq sa është e mundur rregulloret e tjera të brendshme të miratuara nga Këshilli.

Neni 24

Gjuhët zyrtare të procesit

Gjuhët zyrtare të procesit janë gjuha shqipe dhe angleze.

Neni 25

Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare, si dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

VENDIM

Nr. 410, datë 16.7.2025

**PËR MIRATIMIN E RREGULLORES
“PËR MBLEDHJET E PËRBASHKËTA
DHE BASHKËPUNIMIN
NDËRINSTITUCIONAL NDËRMJET
KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR DHE
KËSHILLIT TË LARTË TË
PROKURORISË”**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, në mbështetje të nenit 147 dhe 147/a të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 61, pika 2, germa “ë”, dhe nenit 170, të ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar, me propozim të mbledhjes së përbashkët të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë,



VENDOSI:

1. Miratimin e rregullores “Për mbledhjet e përbashkëta dhe bashkëpunimin ndërinstitucional ndërmjet Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe hyn në fuqi në datën e botimit në Fletoren Zyrtare.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR
KRYETAR
Ilir Rusi

RREGULLORE
PËR MBLEDHJET E PËRBASHKËTA
DHE BASHKËPUNIMIN
NDËRINSTITUCIONAL NDËRMJET
KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR DHE
KËSHILLIT TË LARTË TË PROKURORISË

Neni 1

Qëllimi dhe fusha e zbatimit

1. Kjo rregullore përcakton kuadrin procedural për organizimin, planifikimin, drejtimin dhe zhvillimin e mbledhjeve të përbashkëta midis Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

2. Ajo përcakton përgjegjësitë e secilit këshill në përgatitjen dhe menaxhimin e mbledhjeve të përbashkëta dhe siguron bashkërendimin në fushat me interes të përbashkët institucional, në respekt të plotë të pavarësisë kushtetuese dhe mandateve të veçanta të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

3. Kjo rregullore ofron një bazë për bashkëpunim të strukturuar dhe periodik midis dy këshillave dhe forcon mekanizmat institucionalë të nevojshëm për veprim të përbashkët konsistent dhe efektiv.

Neni 2

Fushat e bashkëpunimit dhe objekti i mbledhjeve të përbashkëta

1. Bashkëpunimi midis Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë, si dhe temat që do të trajtohen në mbledhjet e tyre të

përbashkëta, pasqyrojnë çështje me rëndësi të përbashkët dhe përgjegjësi institucionale, në përputhje me kompetencat e tyre përkatëse kushtetuese dhe ligjore. Në fund të çdo viti kalendarik, Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë, nëpërmjet kryetarëve, dakordësojnë një agjendë vjetore të mbledhjeve të përbashkëta, si dhe çështjet me interes të ndërsjellë që do të trajtohen.

2. Fushat e bashkëpunimit përfshijnë, por nuk kufizohen në sa vijon:

a) seancat e përbashkëta plenare dhe takimet e përbashkëta të komisioneve të përhershme, departamenteve, strukturave këshilluese ligjore dhe njësiteve mbështetëse përkatëse;

b) bashkërendim dhe përafrim në interpretimin dhe zbatimin e dispozitave ligjore, shkëmbim të jurisprudencës dhe praktikave institucionale;

c) nisma legislative dhe reforma të politikave të sektorit të drejtësisë që ndikojnë si në gjyqësor ashtu edhe në prokurori;

d) zhvillimi dhe zbatimi i standardeve etike, rregullave për integritetin dhe mekanizmave të llogaridhënies që zbatohen për magjistratët;

e) strategjitë për transparencë dhe komunikim publik që synojnë forcimin e besimit të publikut në institucionet e drejtësisë;

f) harmonizimi i procedurave dhe politikave në çështjet që lidhen me zhvillimin e karrierës, vlerësimin, transferimin dhe disiplinën e magjistratëve;

g) bashkërendimi në mbledhjen, përpunimin dhe përdorimin e të dhënave gjyqësore dhe Prokurorisë, duke përfshirë informacionin statistikor, treguesit e performancës, si dhe përdorimin e mjeteve digjitale dhe sistemeve të TI-së nëpër gjykata dhe prokurori;

h) bashkërendimi me institucionet e tjera të sektorit të drejtësisë për çështje me rëndësi të përbashkët, duke përfshirë Inspektorin e Lartë të Drejtësisë, Shkollën e Magjistraturës, Prokurorinë e Përgjithshme, Ministrinë e Drejtësisë dhe palët e tjera të interesuara, veçanërisht kur kërkohet përafrim në zbatimin e reformave ligjore ose institucionale;

i) çdo fushë tjetër me rëndësi për funksionimin dhe përmirësimin e sistemit të drejtësisë, ku të dy këshillat kanë një interes të përbashkët institucional.

3. Në fushat ku këshillat identifikojnë interes të përbashkët që përfshijnë institucione të tjera të sektorit të drejtësisë, këto institucione mund të



ftohen të marrin pjesë në mbledhje të përbashkëta ose diskutime specifike. Pjesëmarrja e këtyre institucioneve organizohet dhe koordinohet me marrëveshjen e kryetarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë, bazuar në rëndësinë e temës dhe mandatin institucional të përfshirë.

Neni 3

Shpeshtësia e mbledhjeve të përbashkëta

1. Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë mbajnë jo më pak se dy mbledhje të përbashkëta plenare në vit. Pjesëmarrja në këto mbledhje është e detyrueshme, në përputhje me nenet 68 dhe 166, të ligjit nr. 115/2016. Të paktën një nga mbledhjet duhet të përfshijë një komponent ceremonial, në përputhje me nenin 170, pika 4, të të njëjtit ligj.

2. Çdo Komision i Përhershëm i ngritur sipas neneve 62 dhe 168, të ligjit nr. 115/2016 zhvillon mbledhje të përbashkëta të paktën një herë në gjashtë muaj përgjatë një viti. Këto mbledhje zhvillohen në mënyrë të alternuar në mjediset e Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe trajtojnë çështje që janë në fushën përkatëse të kompetencës së secilit komision.

3. Departamentet përkatëse, strukturat këshilluese ligjore dhe njësitë mbështetëse të dy këshillave mbledhen të paktën një herë në tre muaj, në mënyrë të alternuar në mjediset e secilit këshill, për të bashkërenduar punën për çështje me interes të përbashkët dhe për të ndjekur zbatimin e vendimeve të përbashkëta. Sekretari i Përgjithshëm i secilit këshill merr pjesë në këto mbledhje.

Neni 4

Organizimi dhe rendi i ditës e mbledhjeve të përbashkëta plenare

1. Organizimi dhe rendi i ditës i çdo mbledhjeje të përbashkët plenare dakordësohen paraprakisht nga kryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe kryetari i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, ose nga përfaqësuesit e tyre të autorizuar, me mbështetjen e Sekretariateve Teknike përkatëse.

2. Për çdo mbledhje, Këshilli i Lartë Gjyqësor ose Këshilli i Lartë i Prokurorisë merr përgjegjësinë kryesore për bashkërendimin organizativ dhe logjistik, duke përfshirë thirrjen, organizimin e

mbledhjes në mjediset e tij dhe kryesimin e seancës. Kjo përgjegjësi alternohet midis dy institucioneve.

3. Këshilli përgjegjës për organizimin përgatit projektrendin e ditës në bazë të propozimeve të paraqitura nga të dy institucionet. Projektrendi i ditës i nënshtrohet miratimit të përbashkët nga kryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe kryetari i Këshillit të Lartë të Prokurorisë përpara se të shpërndahet.

4. Propozimet për rendin e ditës mund të paraqiten nga anëtarët e secilit këshill, komisionet tyre të përhershme ose njësitë administrative përkatëse.

5. Kur zyrtarët e nivelit të lartë ftohen të marrin pjesë në përputhje me nenin 170, pika 4, të ligjit nr. 115/2016, rendi i ditës përfshin:

a) një seancë ceremoniale për fjalime institucionale ose prezantime zyrtare;

b) një seancë pune për diskutimin dhe miratimin e konkluzioneve.

6. Rendi i ditës përfundimtar dhe dokumentacioni mbështetës u shpërndahen të gjithë pjesëmarrësve jo më vonë se dhjetë ditë pune para mbledhjes.

Neni 5

Procedura dhe zhvillimi i mbledhjes së përbashkët

1. Mbledhjet e përbashkëta thirren dhe kryesohen në mënyrë të alternuar nga kryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Kryetari i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, ose nga përfaqësuesit e tyre të caktuar.

2. Çdo mbledhje e përbashkët ndjek një rend dite që përfshin fjalët hyrëse, paraqitjen e pikave të rendit të ditës, diskutime të strukturuar dhe formulimin e konkluzioneve operative ose veprimeve vijuese. Zhvillimi i mbledhjes siguron përfaqësim të barabartë dhe pjesëmarrje aktive të dy këshillave.

3. Konkluzionet operative që rezultojnë nga seanca e punës shënohen në një seksion të veçantë të procesverbalit dhe pasqyrojnë pikat e dakortësuara, nismat e përbashkëta ose përpjekjet e planifikuara për bashkërendim.

4. Në mungesë të konsensusit mbi një pikë të caktuar të rendit të ditës, çështja i referohet secilit këshill për diskutim individual dhe ndjekje të duhur institucionale.

5. Procesverbali i çdo mbledhjeje të përbashkët përgatitet nga Sekretariati Teknik dhe u dërgohet të



dy kryetarëve brenda shtatë ditëve të punës për miratim. Procesverbali i miratuar regjistrohet në Zyrën e Protokoll-Arkivit përkatës të secilit institucion dhe shpërndahet siç duhet sipas rastit.

Neni 6

Bashkëpunimi i komisioneve të përhershme dhe departamenteve ligjore

1. Komisionet e përhershme të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë zhvillojnë mbledhje të përbashkëta të paktën një herë në gjashtë muaj përgjatë një viti, në përputhje me nenin 3, të kësaj rregulloreje. Mbledhjet zhvillohen në mënyrë të alternuar në mjediset e secilit këshill.

2. Këto mbledhje trajtojnë çështje që janë në fushat përkatëse të kompetencës së komisioneve, siç përcaktohen në ligjin nr. 115/2016 dhe do të synojnë të sigurojnë bashkërendim dhe konsistencë në praktikat institucionale, përfshirë zbatimin e reformave ligjore dhe strategjike.

3. Departamentet ligjore dhe këshilltarët ligjorë të të dy këshillave mbajnë bashkërendim të vazhdueshëm dhe zhvillojnë mbledhje të përbashkëta të paktën një herë në tre muaj. Këto mbledhje bashkërendohen nën përgjegjësinë e Sekretarit të Përgjithshëm të secilit këshill. Qëllimi i mbledhjeve të tilla është të sigurojë interpretim dhe zbatim të harmonizuar të kuadrit ligjor që rregullon gjyqësorin dhe prokurorinë.

Neni 7

Sekretariati Teknik

1. Secili këshill cakton strukturën e vet administrative përkatëse për të vepruar si Sekretariati Teknik, përgjegjës për zbatimin dhe mbështetjen e dispozitave të kësaj rregulloreje. Sekretariatet teknike funksionojnë nën autoritetin dhe organizimin e secilit Këshill dhe shërbejnë si pika kontakti për komunikim dhe bashkërendim midis Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

2. Për qëllimet e kësaj rregulloreje, Sekretariati Teknik:

a) bashkërendon organizimin logjistik dhe procedural të mbledhjeve të përbashkëta plenare, mbledhjeve të komisioneve të përhershme dhe mbledhjeve të bashkërendimit të departamenteve;

b) ndihmon në përgatitjen, rishikimin dhe shpërndarjen e projekteve të ditës dhe dokumentacionit përkatës;

c) regjistron, përpilon dhe shpërndan procesverbalet dhe konkluzionet operative të mbledhjeve të përbashkëta;

d) monitoron dhe mbështet zbatimin e konkluzioneve, veprimeve vijuese dhe nismave të përbashkëta;

e) mban një regjistër të shkëmbimeve institucionale dhe ofron përditësime të rregullta për kryetarët dhe sekretarët e përgjithshëm të të dy këshillave mbi statusin e bashkëpunimit të vazhdueshëm.

3. Sekretariatet teknike të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë punojnë në bashkërendim për të siguruar vazhdimësinë, konsistencën dhe kujtesën institucionale në kryerjen e veprimtarive të përbashkëta në zbatim të kësaj rregulloreje.

Neni 8

Pjesëmarrja e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, Shkollës së Magjistraturës, Prokurorisë së Përgjithshme dhe institucioneve të tjera

1. Inspektori i Lartë i Drejtësisë dhe Shkolla e Magjistraturës ftohen të marrin pjesë në mbledhjet e përbashkëta të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë, kur rendi i ditës përfshin çështje brenda fushave të tyre përkatëse të përgjegjësisë.

2. Prokuroria e Përgjithshme ftohet të marrë pjesë në mbledhje të përbashkëta për çështje me interes të përbashkët.

3. Me ftesë të kryetarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë, këto institucione mund të paraqesin raporte, të dorëzojnë propozime dhe të marrin pjesë në debatin mbi pikat përkatëse të rendit të ditës, me qëllim që të kontribuojnë në formulimin e konkluzioneve operative.

4. Institucionet e ftuara nuk kanë të drejtë vote, por mund të shprehin pikëpamjet e tyre me gojë ose me shkrim gjatë seancave të punës.

5. Institucionet e tjera të sistemit të drejtësisë gjithashtu mund të ftohen të marrin pjesë në mbledhjet e përbashkëta, me marrëveshje të përbashkët të kryetarëve të Këshillit të Lartë



Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë, bazuar në rëndësinë e rolit të tyre për çështjet që diskutohen.

Neni 9
Aspektet financiare

1. Shpenzimet që lidhen me organizimin dhe zhvillimin e mbledhjeve të përbashkëta të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë mbulohen nga secili këshill brenda kufijve të buxheteve të tyre vjetore përkatëse.

2. Mbledhjet e komisioneve të përhershme, bashkërendimi i këshilltarëve ligjorë dhe aktivitetet e sekretariateve teknike kryhen pa krijuar barrë shtesë financiare dhe ndjekin parimin e kufizimit të kostove.

3. Kur është e përshtatshme, këshillat mund të kërkojnë së bashku ose individualisht mbështetje financiare ose teknike nga institucionet kombëtare, partnerët ndërkombëtarë ose projekte të mbështetura nga donatorët, në përputhje me rregullat financiare dhe të prokurimit në fuqi.

4. Të gjitha praktikatat financiare duhet të respektojnë parimet e pavarësisë dhe transparencës institucionale dhe të kryhen në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator përkatës.

Neni 10
Komunikimi dhe konfidencialiteti

1. Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe Këshilli i Lartë Prokurorisë sigurojnë komunikim të rregullt dhe të strukturuar në zbatimin e kësaj rregulloreje.

2. Vendimet e përbashkëta, konkluzionet operative dhe rezultatet e tjera publikohen në faqet zyrtare të dy këshillave, përveç rasteve kur kufizohen nga legjislacioni në fuqi ose rregullat e brendshme për konfidencialitetin.

3. Informacioni sensitiv ose konfidencial i shkëmbyer ose i diskutuar në kuadër të mbledhjeve të përbashkëta përpunohet në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe procedurat e brendshme që rregullojnë mbrojtjen e të dhënave dhe sigurinë institucionale.

² Në pikën 1, të nenit 5 të ligjit parashikohet se: “1. “Autoritet kompetent” është gjykata, prokuroria dhe çdo organ publik, që ka në kompetencë parandalimin, hetimin, zbulimin ose ndjekjen e veprave penale ose ekzekutimin e dënimeve penale, përfshirë mbrojtjen dhe parandalimin e kërcënimeve ndaj sigurisë publike,

Neni 11

Hyrja në fuqi dhe rishikimi

1. Kjo rregullore hyn në fuqi në ditën e publikimit të saj në Fletoren Zyrtare, pas miratimit të saj nga Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë.

2. Zbatimi i kësaj rregulloreje rishikohet çdo dy vjet, ose më herët nëse vlerësohet e nevojshme me marrëveshje të ndërsjellë, me qëllim vlerësimin e efektivitetit të saj dhe bërjen e ndryshimeve të përshtatshme.

UDHËZIM
Nr. 5, datë 16.7.2025

**PËR PËRPUNIMIN E TË DHËNAVE
PERSONALE NGA AUTORITETET
KOMPETENTE**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 66, germës “d”, të pikës 1, të nenit 82, pikës 1, të nenit 85 dhe pikës 2, të nenit 97, të ligjit nr. 124/2024, “Për mbrojtjen e të dhënave personale” (në vijim quajtur, “Ligji”), Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim “Komisioneri”),

UDHËZON:

Neni 1
Objekti

Ky udhëzim ka për objekt përcaktimin e rregullave për përpunimin e ligjshëm të të dhënave personale nga ana e autoriteteve kompetente², të cilët gjatë veprimtarisë përpunojnë të dhëna personale të administruara në mënyrë manuale dhe elektronike, në zbatim të pjesës III, të ligjit.

Neni 2
Qëllimi

Ky akt nënligjor udhëzon autoritetet kompetente, për mënyrën e përpunimit të ligjshëm

mbrojtjes ose sigurisë kombëtare ose çdo institucion tjetër, të cilit i është dhënë me ligj e drejta për të ushtruar funksione, detyra ose kompetenca publike, në bazë të legjislacionit në fuqi për një ose disa prej këtyre qëllimeve”.



të të dhënave personale që grumbullohen me qëllim parandalimin, hetimin, zbulimin ose ndjekjen e veprave penale ose ekzekutimin e dënimeve penale, përfshirë mbrojtjen dhe parandalimin e kërcënimeve ndaj sigurisë publike, mbrojtjes ose sigurisë kombëtare.

Neni 3

Përkufizime

1. *“Anonimizimi”* është procesi i përdorimit të një grupi teknikash, sipas të cilave të dhënat personale përpunohen në mënyrë të atillë që e bëjnë të pamundur që një person fizik apo juridik t’ia atribuojë këto të dhëna një personi fizik të identifikuar apo të identifikueshëm.

2. *“Nëpunësi për mbrojtjen e të dhënave”* është një ekspert i legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale, që ka rol këshillues dhe ndërgjegjësues në raport me kontrolluesin ose përpunuesin në zbatimin e ligjit. Nëpunësit për mbrojtjen e të dhënave monitorojnë përputhshmërinë e brendshme, informojnë dhe këshillojnë mbi detyrimet që burojnë nga legjislacioni për mbrojtjen e të dhënave dhe veprojnë si një pikë kontakti për subjektet e të dhënave dhe Komisionerin. Në thelb, ata sigurohen që kontrolluesi/përpunuesi t’i përpunojë të dhënat personale në mënyrë të ligjshme.

3. *“Profilizimi i të dhënave”* është çdo formë e përpunimit të automatizuar të të dhënave personale, që konsiston në përdorimin e të dhënave për të vlerësuar aspekte të caktuara që lidhen me një person fizik, veçanërisht për të analizuar ose për të parashikuar aspekte lidhur me performancën në punë, gjendjen ekonomike, shëndetin, preferencat personale, interesat, besueshmërinë, sjelljen, vendndodhjen ose lëvizjet e tij. Kjo përfshin përdorimin e të dhënave për të marrë vendime që ndikojnë ndjeshëm te jeta private e individit.

4. Termat e tjerë të përdorur në këtë udhëzim, kanë të njëjtin kuptim me ato të nenit 5, të ligjit.

Neni 4

Dispozita të përgjithshme

1. Autoritetet kompetente kryejnë përpunimin e të dhënave me mjete të automatizuara ose jo, për

³ Në mbështetje të pikës 1, të nenit 3 dhe nenit 47 të ligjit.

⁴ Parashikuar në nenin 6 dhe 48 të ligjit.

⁵ Në interpretim të pikës 1, të nenit 5 të ligjit do të konsiderohen si autoritete kompetente edhe organe të tjera

Faqe | 19194

garantimin e sigurisë publike ose kombëtare dhe për parandalimin, hetimin, zbulimin ose ndjekjen penale, të veprave penale apo ekzekutimin e dënimeve penale³.

2. Për të dhënat e përpunuara për këto qëllime, autoritetet kompetente duhet në çdo rast të garantojnë zbatimin e parimeve⁴ të ligjshmërisë, përpunimit në përputhje me qëllimin, minimizimit të të dhënave, saktësisë së të dhënave, kufizimit të ruajtjes në kohë, integritetit dhe konfidencialitetit, si dhe përgjegjshmërisë.

3. Autoritetet kompetente caktojnë një nëpunës për mbrojtjen e të dhënave personale.

Neni 5

Fusha e veprimtarisë

1. Ky udhëzim zbatohet për të gjitha përpunimet e të dhënave personale, që kryhen nga ana e Autoriteteve kompetente, të cilat përfshihen në fushën e zbatimit të nenit 47 të ligjit.

2. Autoritet kompetent, do të konsiderohet edhe çdo institucion tjetër, të cilit i është dhënë me ligj e drejta për të ushtruar funksione, detyra ose kompetenca publike, në bazë të legjislacionit në fuqi⁵.

3. Autoritetet kompetente do të zbatojnë parashikimet e këtij udhëzimi vetëm për sa u përket të dhënave personale që përpunohen për këto qëllime specifike. Për sa u përket të dhënave të tjera personale që përpunohen si të dhëna rreth stafit ose për qëllime që nuk lidhen drejtpërdrejt me ato të përcaktuara në pikën 1, të nenit 5 të ligjit, zbatohen si për çdo Kontrollues parashikimet e përgjithshme të pjesës I dhe II të ligjit.

Neni 6

Kategoritë e të dhënave personale

1. Të dhënat personale që përpunohen nga autoritetet kompetente, kategorizohen si më poshtë vijon:

- a) të dhëna të përgjithshme identifikuese;
- b) të dhëna sensitive, përfshirë përkatësinë etnike ose racore, mendimet politike, besimin fetar,

të cilat nuk kanë këtë si objekt primar të veprimtarisë, por kryejnë edhe përpunim të të dhënave për një ose disa prej këtyre qëllimeve (*përfshihen në përkufizim edhe autoritete vendore, kur ndjekin raste që mund të konsiderohen si vepra penale dhe gjobiten*).



anëtarësinë në sindikata, të dhëna biometrike dhe gjenetike, të dhëna për shëndetin, jetën ose orientimin seksual;

c) të dhëna që lidhen me dënime penale, veprat penale dhe masat e sigurimit në lidhje me to etj.

2. Në rastet e përpunimit të të dhënave personale të bazuara në vlerësime personale duhet të mbahet një regjistër i veçantë, duke specifikuar edhe arsyet apo rrethanat për këtë vlerësim.

Neni 7

Ndërveprimi i sistemeve

1. Autoritetet kompetente komunikojnë nëpërmjet ndërveprimit të bazave të të dhënave shtetërore apo sistemeve, të dokumentuar në zbatim të qëllimit të veprimtarisë së tyre.

2. Në rastet kur një informacion rreth subjektit të të dhënave personale rezulton i pasaktë ose duhet të fshihet në zbatim të pikës 6 dhe 7 të nenit 57 të ligjit, Kontrolluesi duhet ta komunikojë këtë informacion te çdo marrës i këtyre të dhënave, në mënyrë që të korrigjohen apo fshihen në çdo bazë të dhënash apo sistem që janë regjistruar, për këtë qëllim të përpunimit.

3. Të gjitha autoritetet kompetente që bashkëpunojnë duhet të garantojnë që përpunimi i të dhënave dhe përhapja e tyre, në zbatim të ligjit, të kryhet në mënyrë konfidenciale dhe të realizohet vetëm nga punonjës të autorizuar.

4. Përpunimi i të dhënave kryhet vetëm në masën e domosdoshme për përmbushjen e qëllimit pa e tejkaluar këtë të fundit.

5. Të dhënat sensitive përpunohen vetëm në rastet e parashikuara në nenin 52 të ligjit.

6. Përmes ndërveprimit të bazave të të dhënave apo sistemeve, autoritetet kompetente duhet të garantojnë gjurmueshmërinë lidhur me veprimet e kryera ndaj të dhënave personale të përpunuara, sipas nenit 62 të ligjit.

Neni 8

Të drejtat e subjekteve të të dhënave personale

1. Autoriteti kompetent, ka detyrimin t'i sigurojë subjektit të të dhënave ushtrimin e të drejtave të tij

⁶ Parashikuar në pikën 1, të nenit 54 të ligjit.

⁷ Kur kjo pengon kërkimet, hetimet, procedurat e zhvilluara nga autoritetet kompetente ose procesin gjyqësor.

në zbatim të neneve 55, 56 dhe 57 të ligjit, duke i ofruar informacionin në një formë koncize, transparente, të kuptueshme dhe lehtësisht të aksesueshme⁶.

2. Kur subjektit të të dhënave nuk mund t'i ofrohet akses në të dhënat e tij personale për shkak të pengesave ligjore për rastin, kërkesa e këtij të fundit mund të vonohet, kufizohet apo refuzohet në atë masë dhe për aq sa është proporcionale, me qëllim shmangien e pengesave⁷ ose mbrojtjen e sigurisë kombëtare.

3. Në çdo rast, autoritetet kompetente duhet të dokumentojnë faktet dhe arsyet ligjore të refuzimit të së drejtës për akses, sipas pikës 2 të këtij neni.

4. Subjektet e të dhënave kanë të drejtë të kërkojnë pranë Komisionerit, rishikimin e përgjigjes së dhënë nga ana e autoriteteve kompetente, lidhur me kërkesën e tyre dhe ligjshmërinë e përpunimit të të dhënave personale.

Neni 9

Transferimi i të dhënave personale

1. Transferimet e të dhënave personale nga ana e autoriteteve kompetente, do të kryhen vetëm në zbatim të neneve 70–74 të ligjit.

2. Në rastin e transferimit të të dhënave personale në mungesë të një vendimi përshtatshmërie, autoritetet kompetente duhet të informojnë Komisionerin, për kategoritë e transferimeve që janë kryer sipas pikës 2, të nenit 72 të ligjit.

Neni 10

Masat e sigurisë

1. Autoritetet kompetente duhet të marrin masa për arritjen e objektivave specifike të sigurisë, duke kryer vlerësimin e ndikimit në mbrojtjen e të dhënave, kur aktivitetet e përpunimit të të dhënave kanë të ngjarë të rezultojë në një rrezik të lartë për të drejtat dhe liritë e subjekteve të të dhënave. Ky vlerësim i ndikimit përfshin, si identifikimin e rreziqeve edhe përcaktimin e masave që duhen ndërmarrë për zbutjen e tyre⁸.

2. Në rastin e përdorimit të sistemeve apo pajisjeve të ndryshme teknologjike, autoritetet

⁸ Vlerësimi i ndikimit në mbrojtjen e të dhënave parashikohet në nenin 64 të ligjit.



kompetente duhet të ndërmarrin masa për mbrojtjen e të dhënave në projektim dhe në mënyrë të paracaktuar. Mbrojtja e të dhënave personale gjatë proceseve të përpunimit do të respektohet më mirë kur ajo është e integruar në teknologji që në momentin që ajo krijohet. Për rrjedhojë, duhet të ndërmerren masat teknike dhe organizative që në kohën e planifikimit të një sistemi përpunimi, për të mbrojtur sigurinë e këtyre të dhënave.

3. Në zbatim të nenit 61 të ligjit, autoritetet kompetente duhet të kryejnë dokumentimin e veprimtarive të përpunimit, në të cilin përmbahen edhe informacionet rreth përdorimit të profilizimit.

4. Autoritetet kompetente duhet të garantojnë nivelin e sigurisë së të dhënave duke përfshirë planet e sigurisë, përditësimin e sistemeve të TI dhe masave organizative, kryerjen e vlerësimit të ndikimit (veçanërisht kur përdoret një teknologji e re) dhe regjistrimin⁹ e veprimeve të veçanta të përpunimit.

5. Autoritetet kompetente, si kontrollues, në rast cenimi të të dhënave duhet të njoftojnë Komisionerin, si dhe subjektin e të dhënave.

6. Të gjithë punonjësit e autoriteteve kompetente, që i nënshtrohen këtij udhëzimi, janë të detyruar të mbajnë konfidenciale të dhënat e përpunuara gjatë ushtrimit të funksionit edhe pas përfundimit të tij.

7. Përpunimi i të dhënave sensitive dhe veçanërisht atyre biometrike dhe gjenetike kërkon masa të posaçme mbrojtje dhe kontrolli të dyfishtë, përfshirë administrim të ndarë dhe të mbrojtur fizikisht apo në sisteme të dedikuara.

Neni 11

Mekanizmat konfidencialë të raportimit

1. Autoritetet kompetente krijojnë dhe përdorin mekanizma apo kanale të sigurta dhe konfidenciale, që garantojnë raportimin e shkeljeve të ligjit¹⁰.

2. Mekanizmat e raportimit që garantojnë konfidencialitetin nga autoritetet kompetente, janë:

a) e-mail i dedikuar me qasje të kufizuar;

b) platformë *online* për përdorim të brendshëm, sipas aksesit të autorizuar;

c) kuti/pajisje fizike të dedikuara të raportimit, të vendosura në ambientet e institucionit;

d) raportim verbal me mbajtje protokolli në zyrë të caktuar.

e) çdo formë tjetër raportimi që përmbush kërkesat e ligjit.

3. Në çdo rast të raportimit, autoritetet kompetente janë të detyruara të garantojnë konfidencialitetin e identitetit të raportuesit dhe personave të përfshirë.

4. Çdo autoritet kompetent duhet të miratojë procedura të brendshme të qarta për trajtimin e raporteve, si dhe afatet për ruajtjen dhe asgjësimin e tyre, me qëllim dokumentimin dhe përmbushjen e detyrimeve ligjore, sipas nenit 69 të ligjit.

Neni 12

Ruajtja dhe fshirja e të dhënave

1. Autoritetet kompetente duhet të parashikojnë në kuadrin e tyre rregullator afate të përshtatshme kohore për fshirjen e të dhënave personale, afate të rishikimit periodik të ruajtjes së tyre, si dhe të ndërmarrin masa konkrete për respektimin e këtyre afateve¹¹.

2. Të dhënat personale duhet të ruhen në një formë që lejon identifikimin e subjekteve të të dhënave për aq kohë sa është e nevojshme për përmbushjen e qëllimit/eve për të cilin/at ato përpunohen. Prandaj, të dhënat personale duhet të fshihen ose të anonimizohen, në atë moment që nuk do të jenë më të nevojshme për qëllimin/et për të cilin/at, ato janë mbledhur në mënyrë të ligjshme nga autoritetet kompetente¹².

3. Të dhënat personale, kur përpunohen vetëm për qëllime arkivimi në interes publik, për qëllime kërkimore shkencore ose historike apo për qëllime statistikore, mund të ruhen për një periudhë më të gjatë sesa është e nevojshme për përmbushjen e qëllimit për të cilin janë grumbulluar. Kjo është e kushtëzuar me zbatimin e masave të duhura teknike

⁹ Detyrimi për regjistrim, parashikohet në nenin 62 të ligjit.

¹⁰ Shembull: Një punonjës policie konstaton se informacionet mbi të ndaluarit ruhen në platforma jo të sigurta ose shpërndahen në WhatsApp, në grupe, në mënyrë të paautorizuar. Punonjësi mund të raportojë këtë shkelje si përpunim i paligjshëm i të dhënave personale,

përmes një mekanizmi të brendshëm, si kutia fizike e raportimit, portali online ose një email-i të dedikuar.

¹¹ Masat për respektimin e afateve mund të kryhen automatikisht nëpërmjet sistemit (mbrojtja e të dhënave në projektim dhe në mënyrë të paracaktuar - *privacy by design*) ose manualisht duke caktuar një person përgjegjës.

¹² Sipas nenit 57 të ligjit.



dhe organizative, siç janë, në veçanti, pseudonimizimi ose anonimizimi, me qëllim mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të subjekteve të të dhënave në përputhje me *“parimin e kufizimit të ruajtjes në kohë”*¹³.

4. Autoritetet kompetente duhet të respektojnë në përputhje me fushën e tyre të kompetencës, të gjitha veprimtaritë e përpunimit të të dhënave personale duke siguruar që të dhënat të jenë të sakta dhe që periudhat e ruajtjes së të dhënave të respektohen. Të dhënat personale duhet të përditësohen kur ato nuk janë më të sakta, si dhe të fshihen nga baza e të dhënave kur ato nuk janë më të nevojshme për qëllimin e mbledhjes së tyre¹⁴.

5. Kur të dhënat personale janë korrigjuar ose fshirë, autoriteti kompetent duhet të njoftojë të gjithë marrësit e të dhënave personale përkatëse¹⁵.

Neni 13

Kriteret për rishikimin e nevojës për vazhdimin e ruajtjes së të dhënave

Në përcaktimin e nevojës për vazhdimin e ruajtjes së të dhënave personale, duhet të merren parasysh kriteret e mëposhtme:

a) mosha e subjektit të të dhënave, duke i kushtuar një vëmendje të veçantë të miturve dhe personave të moshuar;

b) dënimet e shlyera, në rastin kur një person ka përfunduar dënimin e tij/saj me heqje lirie dhe ndërkohë periudha e parë e rishikimit ka kaluar, të dhënat e tij/saj personale duhet të fshihen, përveç rasteve kur ka prova se të dhënat janë të nevojshme për hetime të tjera në vazhdim. Në rastin e të dhënave sensitive, ato duhet të fshihen, përveç rasteve kur është e domosdoshme që ato të ruhen për shkak të hetimeve të tjera në vazhdim;

c) vendimet gjyqësore, veçanërisht vendimet për pafajësi që lidhen me vepra të caktuara penale, ku i gjithë informacioni mbi çështjet duhet të fshihet, përveç rasteve kur ka prova se të dhënat janë të nevojshme për hetime të tjera në vazhdim. Në rastin e përpunimit të të dhënave sensitive, ato duhet të fshihen, me përjashtim të rasteve kur është e domosdoshme që ato të ruhen për shkak të hetimeve të tjera në vazhdim. Të njëjtat kriteret

mund të zbatohen në rastet e amnistisë ose rehabilitimit.

Neni 14

Dispozita përfundimtare

1. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen të gjitha autoritetet kompetente.

2. Udhëzimi nr. 17, datë 11.5.2012, “Mbi përcaktimin e kohës së mbajtjes së të dhënave personale që përpunohen në sistemet elektronike, nga organet e policisë së shtetit për qëllime parandalimi, hetimi, zbulimi dhe ndjekje të veprave penale”, shfuqizohet.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E
INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

Besnik Dervishi

URDHËR

Nr. 172, datë 16.7.2025

PËR DELEGIM KOMPETENCASH NGA KRYETARI I AUTORITETIT PËR INFORMIMIN MBI DOKUMENTET E ISH-SIGURIMIT TË SHTETIT TEK SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

Në mbështetje të nenit 9/1 të ligjit nr. 45/2015, “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, të ndryshuar; neneve 22, pika 3, 28, 29, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; ligjit nr. 10 019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar; ligjit nr. 10 296, datë 8.7.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar; ligjit nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar; ligjit nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”, të ndryshuar; vendimit të Kuvendit nr. 95/2016, “Për miratimin e strukturës, organikës dhe kategorizimin e pozicioneve të punës të institucionit të Autoritetit për Informim mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të

¹³ Parashikuar në pikën 5, të nenit 6 të ligjit, si dhe nenin 45 të ligjit.

¹⁴ Në zbatim të nenit 6 dhe 57 të ligjit.

¹⁵ Detyrim që citohet në pikën 7 të nenit 57 të ligjit.



Shtetit”; nenit 73, pika 2, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.5.2021, “Për përcaktimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar; neneve 11, 40, 48, pika 3, të rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit”, miratuar me vendimin nr. 96, datë 12.2.2024, të Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit; nenit 4, pika 4, të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, “Për rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik të çdo institucioni publik, e me kapital shtetëror, agjencie, enteve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”, ndryshuar me vendimin nr. 16, datë 21.12.2024, të Komisionit Rregullator pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator ‘Për rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik të çdo institucioni publik, e me kapital shtetëror, agjencie, enteve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve’”,

URDHËROJ:

1. Delegimin të sekretari i përgjithshëm i Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, znj. Sofi Noti, të:

a) ushtrimit të kompetencave, funksioneve dhe përgjegjësi të titullarit të Autoritetit Kontraktor për Autoritetin për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, për organizimin, ndjekjen dhe realizimin e të gjitha procedurave të prokurimit publik të institucionit, në përputhje me legjislacionin e prokurimeve;

b) menaxhimit dhe kontrollit të riskut, sipas parashikimeve të ligjit nr. 10 296, datë 8.7.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar, si dhe akteve të dala në zbatim të tij;

c) funksionin e personit përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike gjatë fushatës zgjedhore, sipas përcaktimeve të gjendura në ligjin nr. 10 019,

datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” dhe në vendimin nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, “Për rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik të çdo institucioni publik, e me kapital shtetëror, agjencie, enteve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”, të ndryshuar;

d) ushtrimit të kompetencave ligjore dhe të funksioneve të zbatimit të programit të transparencës, siç ato përcaktohen dhe parashikohen në ligjin nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar;

e) përcjelljes së informacionit dhe dhënies së dublikatave në zbatim të ekzekutueshmërisë së vendimeve të marra nga Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, në rastet kur ky informacion mund të jepet brenda masës dhe parashikimeve ligjore;

f) përfaqësimin dhe ndjekjen e çështjeve me karakter administrativ që lidhen me veprimtarinë e sekretariatit teknik dhe të stafit të Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, të tilla si, shkëmbim informacioni apo ndjekje e procedurave të rekrutimit të stafit.

2. Ky delegim kompetencash vlen për një afat të pacaktuar dhe mbaron vetëm me revokimin e këtij urdhri.

3. Ngarkohet sekretari i përgjithshëm, znj. Sofi Noti, për zbatimin e këtij urdhri.

4. Të njihen anëtarët e Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit me këtë urdhër.

5. Ngarkohet Sektori i Arkiv-Protokollit në Drejtorinë e Shërbimeve të Brendshme dhe Financës, për njoftimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

KRYETAR
Gentiana Sula

Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2025

Adresa: Rr. “Nikolla Jorga”, Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 240 lekë

